



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2026¹

¹ Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2026 është miratuar në mbledhjen e 7-të të Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, me Vendimin nr. 01/1065, të datës 19.12.2025.



©**Akademia e Drejtësisë 2025**, Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave.....	6
Hyrje	7
Përmbyshja e Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2025 dhe sfidat gjatë realizimit të tij	8
Vizioni dhe misioni.....	11
1. Rëndësia e Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2026.....	12
2. Baza ligjore dhe funksionet e Akademisë.....	12
3. Organet e Akademisë së Drejtësisë.....	14
3.1 Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë	15
3.2 Këshilli Programor i Akademisë së Drejtësisë.....	15
3.3 Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë	16
I. Objektivat e përgjithshme të Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2026.....	17
1. Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar	17
1.1. Zbatimi i trajnimit fillestar për 21 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së XIII	18
1.2. Zbatimi i trajnimit fillestar për 24 prokurorët e sapoemëruar, gjenerata e XI	19
1.3. Zbatimi i trajnimit fillestar duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik për 20 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së XIV	19
1.4. Zbatimi i trajnimit fillestar duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik për 20 prokurorë të sapoemëruar të gjeneratës së XII	19
1.5. Zbatimi i trajnimit fillestar për 20 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së XV dhe 8 gjyqtarë të komunitetit serb.....	20
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor e prokurorial, si dhe profesionistëve të tjerë ligjorë	20
2.1 Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026, përkatësisht Plani i Veprimit për vitin 2024-2026	21
2.2 Zbatimi i trajnimeve sipas prioriteteve të KGJK-së dhe KPK-së si dhe nevojave trajnuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve.....	23
2.3 Realizimi i trajnimeve përmes tryezave për adresimin e problemeve praktike dhe çështjeve nga praktika gjyqësore	24
2.4 Zbatimin e trajnimeve për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive.....	24
Pjesë e Programit për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2026 janë edhe trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive. Këto trajnime synojnë avancimin e njohurive të kryetarëve, kryeprokurorëve, gjyqtarëve mbikëqyrës të degëve, si dhe udhëheqësve të departamenteve dhe divizioneve, me qëllim përforcimin e aftësive për ushtrimin e përgjegjësiave menaxheriale në gjykata dhe prokurori.....	24
2.5 Zbatimi i trajnimeve të përbashkëta me odat e profesioneve të lira.....	24
2.6 Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor	24
2.7 Zbatimi i trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	25
2.8 Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas vlerësimit të Performancës.....	25

2.9	Zbatimi i trajnimit të trajnuesve sipas metodologjisë së përcaktuar në Doracakun për Trajnues.....	25
2.10	Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë	25
2.11	Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2027.....	26
3.	Zhvillimi i programeve trajnuese, ngritja e cilësisë së trajnimeve, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese	26
3.1	Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese dhe nevojave për botime ligjore për përfituesit e AD-së sipas ligjit për vitin 2026.....	27
3.2	Zhvillimi i procesit për vlerësimin e ndikimit të trajnimeve dhe vlerësimit të performancës së trajnuesve për vitin 2026 dhe rekrutimi i trajnerëve të rinj.....	27
3.3	Zhvillimi i botimeve të reja dhe ofrimi i këtyre burimeve ligjore për përfituesit e trajnimeve të AD-së	28
3.4	Zbatimi i masave dhe politikave euro-integruese si dhe raportimi i rregullt në mekanizmat përkatës	29
3.5	Zhvillimi i strategjisë institucionale dhe planit të veprimit të Akademisë së Drejtësisë .	29
4.	Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me partnerët vendorë, donatorët, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare.....	30
4.1	Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës.....	30
4.2	Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët, institucionet dhe organizatat tjera ndërkombëtare	30
5.	Ngritja e kapaciteteve profesionale administrative, cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit.....	31
5.1	Ngritja e cilësisë së shërbimeve ligjore dhe mbështetja e organeve të Akademisë së Drejtësie	32
5.2	Ngritja e Komunikimit Institucional dhe Marrëdhënieve me Publikun.....	33
5.3	Avancimi i sistemeve të TI-së, mirëmbajtja dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve	33
5.4	Avancimi i kapaciteteve profesionale administrative, proceseve të personelit, dhe rritja e efikasitetit në proceset e punës.....	34
5.5	Ngritja e cilësisë së shërbimeve të mbështetjes administrative, logjistike, dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike	35
5.6	Ngritja e cilësisë së furnizimeve me mallra dhe shërbime dhe menaxhimi efektiv i kontratave.....	36
5.7	Menaxhimi dhe zbatimi në mënyrë efektive të resurseve financiare	37
6.	Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së.....	38
7.	Sfidat dhe rreziqet	53
7.1	Sfidat dhe rreziqet në fushën e financave dhe përmirësimit të infrastrukturës	53
7.2	Sfidat dhe rreziqet në fushën e burimeve njerëzore dhe administrimit.....	53
7.3	Sfida dhe rreziqe në çështjet e zbatimit të legjislacionit dhe avancimin institucional	54
7.4	Sfidat dhe rreziqet në fushën teknologjike dhe të sistemeve të informacionit.....	54

7.5	Sfidat dhe rreziqet ne aktivitet trajnuese, hulumtuese dhe botuese.....	54
8.	Përfundimi.....	55

Lista e shkurtesave

ABEK – Asociacioni i Bibliotekave Elektronike të Kosovës
AD – Akademia e Drejtësisë
AQP – Agjencia Qendrore e Prokurimit
BE – Bashkimi Evropian
FMCS – Federal Mediation and Conciliation Service
ENM – École Nationale de la Magistrature
EJTN – European Judicial Training Network
ERA - Academy of European Law
EULEX – European Union Rule of Law Mission
GIZ – Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
INL – Bureau of International Narcotics and Law Enforcement Affairs
KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OPDAT – Office of Overseas Prosecutorial Development
PHP – Programi për Hulumtime dhe Publikime
PTF – Programi i Trajnimit Fillestar
PTV – Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm
SIMFK – Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
TI – Teknologjia Informative
USAID – The United States Agency for International Development
UNDP – United Nations Development Programme
UNODC – United Nations Office on Drugs and Crime

Hyrje

Plani i Punës dhe i Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026 është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, si dhe në zbatim të Rregullores nr. 12/2023 për sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore. Ky dokument përbën instrumentin themelor të planifikimit vjetor, i cili përcakton objektivat strategjike dhe operacionale, si dhe paraqet sekuencën e aktiviteteve për zbatimin e tyre, në përputhje me mandatin ligjor të Akademisë së Drejtësisë.

Ky plan përfaqëson dokumentin kryesor udhëzues për planifikimin vjetor të aktiviteteve të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026 dhe, njëkohësisht, siguron harmonizimin e veprimeve konkrete të Akademisë së Drejtësisë me prioritetet strategjike të sistemit të drejtësisë në Kosovë.

Përmes këtij dokumenti janë planifikuar objektivat që synohen të realizohen gjatë vitit 2026, në përputhje me nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të të gjithë kuadrit ligjor në gjykata dhe prokurori, duke përfshirë edhe kuadrin mbështetës. Plani përfshin veprime konkrete për zbatimin e programeve trajnuese dhe të aktiviteteve të tjera të përcaktuara me ligj, të cilat janë në përputhje me zhvillimet e reja, duke u bazuar në kapacitetet dhe resurset e departamenteve dhe divizioneve përkatëse të këtij institucioni, si dhe në përvojën dhe praktikën më të mira për realizimin e tyre. Plani i Punës dhe i Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026 përfshin aktivitetet që janë në funksion të zbatimit të programeve të trajnimit fillestar dhe të trajnimeve të vazhdueshme, si dhe aktivitete të tjera të përcaktuara me ligj.

Objektivat e përgjithshme dhe specifike të Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2026 janë strukturuar në pesë fusha kryesore, të cilat përfshijnë:

1. Përgatitjen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar, në pajtim me programin e trajnimit fillestar;
2. Avancimin e njohurive profesionale dhe ndërdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ dhe profesionistëve të tjerë ligjorë;
3. Zhvillimin e programeve trajnuese, rritjen e cilësisë së trajnimeve, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese;
4. Forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar në funksion të realizimit të mandatit ligjor të Akademisë;
5. Ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe administrative të institucionit, si dhe menaxhimin efikas të burimeve buxhetore.

Në vijim të këtij dokumenti, secili objektiv është i zbërthyer në nënobjektiva përkatëse, njësi përgjegjëse, afate kohore të realizimit dhe indikatorë të performancës, të cilët mundësojnë monitorim të rregullt, matje të rezultateve dhe raportim të standardizuar, në përputhje me kërkesat e sistemit të menaxhimit të performancës.

Në tërësi, Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2026 synon të garantojë ushtrimin efikas të mandatit ligjor të Akademisë së Drejtësisë në forcimin e kapaciteteve profesionale të sistemit

të drejtësisë në Republikën e Kosovës, përmes ofrimit të trajnimeve të nevojshme, përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së trajnimeve dhe ofrimit të shërbimeve profesionale teknike dhe administrative.

Në funksion të përmbushjes së Planit të Punës dhe të Performancës, në vijim të këtij plani është përgatitur dhe është pasqyruar secili objektivi, përkatësisht nënobjektiv, ndërsa më pas është paraqitur, në formë tabelare, plani i veprimeve për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara.

Përmbushja e Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2025 dhe sfidat gjatë realizimit të tij

Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar edhe gjatë vitit 2025 ka mbetur ndër objektivat kryesore të Akademisë së Drejtësisë për përgatitjen profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj. Trajnimet janë realizuar në përputhje me Planin e Punës dhe kalendarin e trajnimeve. Trajnimet fillestare për aftësimin e gjeneratave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj janë realizuar me sukses, ndërsa disa prej tyre janë ende në proces të realizimit.

Gjatë vitit 2025, në kuadër të programit të trajnimit fillestar janë trajnuar gjithsej 87 gjyqtarë (gjeneratat XI, XII, XIII dhe XIV) dhe 24 prokurorë të rinj (gjenerata XI).

Deri në muajin shkurt të vitit 2025 është vazhduar zbatimi i trajnimit praktik për gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës XI-të, ndërsa për gjeneratën XII-të të gjyqtarëve të sapoemëruar është vazhduar zbatimi i një pjese të trajnimit teorik, si dhe i tërësisë së trajnimit praktik në gjykatat përkatëse, deri në muajin tetor. Për të dy gjeneratat (XI dhe XII) e gjyqtarëve të sapoemëruar që kanë përfunduar trajnimet fillestare janë realizuar testet përfundimtare me rezultate pozitive dhe janë përgatitur raportet me vlerësimet përfundimtare për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Në proces të realizimit të trajnimit fillestar janë gjeneratat XIII-të dhe XIV-të të gjyqtarëve të sapoemëruar, si dhe gjenerata XI-të e prokurorëve të sapoemëruar, në përputhje me kalendarin dhe programin trajnues. Sa i përket gjeneratës XI-të të prokurorëve të sapoemëruar, trajnimi fillestar ka filluar në muajin janar 2025 dhe realizohet përmes kombinimit të trajnimit teorik dhe praktik, përkatësisht dy ditë trajnim teorik në Akademinë e Drejtësisë dhe tri ditë trajnim praktik në prokuroritë përkatëse, me pritje që të përfundojë në muajin shkurt 2026. Ndërkohë, zbatimi i trajnimit fillestar për gjeneratën XIII-të të gjyqtarëve të sapoemëruar pritet të përfundojë në muajin maj 2026, ndërsa trajnimi fillestar për gjeneratën XIV-të të gjyqtarëve të sapoemëruar pritet të përfundojë në muajin nëntor 2026.

Akademia e Drejtësisë ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për zbatimin e programit trajnues për gjeneratën XII-të të prokurorëve, i cili, sipas planifikimit, ishte paraparë të fillonte në pjesën e parë të vitit 2026. Mirëpo, pas përfundimit të procesit përkatës, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka vendosur të anulojë procedurën e rekrutimit.

Akademia e Drejtësisë, në vazhdimësi, monitoron zhvillimet e proceseve të rekrutimit dhe, në koordinim të ngushtë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe KPK-në, rishqyrton dhe përditëson programet e trajnimit fillestar, në përputhje me vlerësimin e nevojave që reflektojnë dinamikën e zhvillimeve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë, sipas kërkesës dhe vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), ka hartuar dhe zbatuar trajnim të detyrueshëm për gjyqtarë me mandat të përhershëm. Në këtë drejtim, në koordinim të ngushtë me KGJK-në, përkatësisht në përputhje me vendimin e tij dhe në pajtim me Protokollin për Trajnime të Detyrueshme për Gjyqtarë, Akademia ka hartuar dhe zbatuar planin e trajnimit për një gjyqtar.

Avancimi i kapaciteteve profesionale dhe ndërdisiplinore të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë ligjorë mbetet çështje thelbësore për sigurimin e një sistemi gjyqësor efikas, të drejtë dhe etik. Gjatë vitit 2025, Programi për Trajnime të Vazhdueshme ka arritur të përmbushë objektivat, përkatësisht të gjitha nënobjektivat, ashtu siç janë paraparë në Planin e Punës dhe të Performancës për vitin 2025. Në kuadër të realizimit të programit vjetor të trajnimeve të vazhdueshme për vitin 2025, janë realizuar gjithsej 196 aktivitete trajnuese për gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtorë profesionalë, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë ligjorë.

Në këtë kontekst, një numër i konsiderueshëm nënobjektivash që lidhen me avancimin e vazhdueshëm profesional të gjyqtarëve, prokurorëve, bashkëpunëtorëve profesionalë dhe stafit administrativ gjyqësor e prokurorial janë realizuar. Sipas prioritetëve, fillimisht është realizuar zbatimi i trajnimeve të parashikuara me dokumentet strategjike, veçanërisht me Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2021–2026 dhe Programin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut. Janë zbatuar të gjitha aktivitetet trajnuese të parapara dhe të planifikuara, duke përfshirë fushat penale, civile, administrative dhe komerciale, si dhe fushat që lidhen me të drejtat e njeriut, përfshirë trajnimet kundër dhunës në familje, kundër dhunës me bazë gjinore, mosdiskriminimit, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), si dhe trajnimet mbi lirinë e shprehjes dhe gjuhën e urrejtjes. Gjithashtu, është rishikuar dhe zbatuar kurrikula e trajnimeve për dhunën në familje, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës.

Këto arritje dëshmojnë ngritjen e kapaciteteve profesionale brenda sistemit dhe efektivitetin e planifikimit të aktiviteteve trajnuese, gjë që ka mundësuar që Akademia të siguroj përshtatshmëri më të madhe të programeve me kërkesat aktuale të praktikës gjyqësore.

Në realizim të nënobjektivave të Planit të Punës, respektivisht të Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2025, me sukses janë realizuar 114 aktivitete trajnuese për bashkëpunëtorët profesionalë, zyrtarët ligjorë, si dhe stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Ndërsa, sipas kërkesës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), dhe në koordinim të ngushtë, janë realizuar 103 aktivitete trajnuese në kuadër të programit të trajnimit fillestar dhe programit të trajnimit të vazhdueshëm për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial. Gjithashtu, gjatë këtij viti janë realizuar aktivitete trajnuese të përbashkëta me profesionet e lira, në bashkëpunim të ngushtë me odat dhe agjencitë përkatëse, duke përfshirë ndërmjetësuesit, përmbaruesit, mbrojtësit e viktimave dhe zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Realizimi i aktiviteteve trajnuese përmes metodologjisë së zbatuar në formën e tryezave për unifikimin e praktikës gjyqësore tashmë është shndërruar në një praktikë të qëndrueshme dhe efektive, duke kontribuar në harmonizimin e qasjeve gjyqësore në fusha të caktuara të së drejtës. Në kontekst të ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve të trajnuesve, si dhe avancimit dhe zbatimit të metodologjisë në realizimin e programeve trajnuese, në vazhden e ciklit të trajnimeve për trajnues sipas metodologjisë së Doracakut për Trajnues, është realizuar një trajnim dy ditor për trajnues, ku janë trajnuar 20 pjesëmarrës, përfshirë gjyqtarë, prokurorë dhe ekspertë të tjerë të fushave të drejtësisë. Ky grup përbën edhe listën e fundit të trajnuarave të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2025.

Përkundër sukseseve dhe të arriturave në këtë objektiv, gjatë vitit 2025 një pjesë e nënobjektivave mbetet për t'i realizuar gjatë vitit 2026. Këto përfshijnë përmbushjen e plotë të masave të parashikuara në Strategjinë për Sundimin e Ligjit 2024–2026, me theks të veçantë në zhvillimin e kurrikulave të reja, realizimin e analizave për specializim, si dhe zhvillimin e moduleve të reja për mësim në distancë përmes platformës elektronike të Akademisë së Drejtësisë.

Po ashtu, në vitin 2026 mbetet për t'i realizuar zbatimi i aktiviteteve trajnuese të specializuara që lidhen me organet dhe komisionet me rol në proceset e vlerësimit, verifikimit dhe rekrutimit.

Në procesin e realizimit dhe zbatimit të aktiviteteve trajnuese gjatë vitit 2025 janë hasur disa vështirësi dhe sfida të theksuara. Një ndër to ka qenë vonesa në koordinimin e aktiviteteve trajnuese që varen nga institucionet e tjera të drejtësisë, ku Akademia e Drejtësisë ka pasur vetëm rol mbështetës. Në raste të caktuara, këto vonesa në komunikim me institucionet gjegjëse kanë ngadalësuar procesin e realizimit të aktiviteteve trajnuese. Një sfidë tjetër për Akademinë e drejtësisë (AD) ka qenë organizimi i trajnimeve shumë specifike për komisionet dhe organet që merren me vlerësimin e performancës dhe verifikimet profesionale, duke krijuar nevojën për angazhimin e ekspertëve të fushës, të cilët aktualisht nuk janë identifikuar ende.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 është vënë re një pjesëmarrje e ulët në aktivitetet e trajnimeve të vazhdueshme, respektivisht mungesa e disa gjyqtarëve dhe prokurorëve në trajnim, përkundër aplikimeve dhe konfirmimeve paraprake për pjesëmarrje.

Ndërsa, buxheti i limituar për aktivitetet trajnuese, sikurse edhe në vitet paraprake, ka ndikuar në planifikimin dhe realizimin strategjik të aktiviteteve trajnuese të Akademisë së Drejtësisë.

Edhe këtë vit, Akademia e Drejtësisë ka zhvilluar dhe përfunduar me sukses vlerësimin vjetor të nevojave trajnuese për gjyqtarë, prokurorë dhe staf administrativ. Në procesin e realizimit të këtij vlerësimi, sikurse edhe në vitet paraprake, janë përfshirë të gjithë akterët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, duke përfshirë gjyqtarët, prokurorët, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare që mbështesin institucionet e sistemit të drejtësisë. Në kuadër të këtij procesi janë realizuar takime dhe punëtori me gjyqtarë, prokurorë dhe krerë të gjykatave dhe prokurorive, si dhe janë mbledhur dhe analizuar të dhëna nga mekanizmat e brendshëm dhe strategjitë përkatëse. Të dhënat dhe informacionet e mbledhura përmes instrumenteve të vlerësimit të nevojave janë analizuar dhe përpunuar, duke përfshirë edhe rekomandimet e dala nga dokumentet strategjike të vendit, raportet monitoruese të vendit dhe ato të institucioneve ndërkombëtare. Në përfundim të këtij procesi, është hartuar dhe miratuar Programi Vjetor për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2026, si dhe programet e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar.

Në fushën e publikimeve është realizuar procesi i vlerësimit të nevojave për botime të reja ligjore për vitin 2026, ndërsa gjatë vitit 2025 janë realizuar botimet periodike, modulet trajnuese sipas programit trajnues të PTF-së, si dhe botimet: Drejtësia Mjedisore, Aspekte të Rëndësishme nga e Drejta Penale dhe Udhëzuesi për Provat Elektronike. Gjithashtu, janë realizuar publikime me Gjykatën Supreme, përfshirë: Vendimet e Përzgjedhura në Çështje Penale dhe Civile dhe Përmbledhja e Praktikës së Gjykatës Supreme në Çështje Penale dhe Civile.

Vlerësimi i ndikimit të trajnimeve mbetet një nënobjektiv me prioritet, dhe gjatë viteve të fundit Akademia e Drejtësisë ka arritur të ndërtojë një proces solid, duke aplikuar mekanizma dhe praktika të mira në metodologjinë e monitorimit dhe mbledhjes së të dhënave për matjen e ndikimit të trajnimit. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave, përmes aplikimit të kësaj metodologjie, edhe pse ndodhet në fazën fillestare të zbatimit, do t'i mundësojë Akademisë të monitorojë dinamikën dhe nivelin e përvetësimit të njohurive të fituara nga pjesëmarrësit. Në aktivitetet e ndërlidhura me ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve të trajnuesve, sipas

metodologjisë trajnuese të Akademisë, është vazhduar me sukses zbatimi i procesit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së trajnerëve të angazhuar në realizimin e programeve trajnuese. Zbatimi i këtij procesi ka ndikuar në rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës në ofrimin e trajnimeve, si dhe ka përmirësuar cilësinë metodologjike të materialeve të përdorura gjatë trajnimeve.

Vështirësitë dhe sfidat kryesore, sikurse edhe në vitet e kaluara, kanë vazhduar të jenë prezente edhe gjatë vitit 2025. Ndër to përfshihen buxheti i limituar, mungesa e burimeve të nevojshme për zhvillimin e vlerësimit të ndikimit të trajnimeve në vendin e punës, si dhe interesi jo i mjaftueshëm për shkrime ligjore nga profesionistët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Aktivitetet e Akademisë së Drejtësisë edhe këtë vit kanë synuar ngritjen e kapaciteteve profesionale administrative, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve administrative, si dhe menaxhimin e shpenzimeve financiare në përputhje me nevojat e programeve trajnuese. Në kuadër të ngritjes profesionale administrative, Akademia e Drejtësisë ka realizuar hartimin e Rregullores Nr. 01/2025 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 05/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Gjithashtu, ka vazhduar të ofrojë mbështetje organeve të Akademisë së Drejtësisë përmes analizave dhe komentimeve të akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe trajtimin e çështjeve juridike në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë kontekst, Akademia ka iniciuar rishikimin dhe hartimin e akteve nënligjore që parashihen për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Zyrtarët Publik, respektivisht të gjitha aktet nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës për nëpunësit civilë me status të veçantë. Statusi i nëpunësit civil të Akademisë së Drejtësisë, në pajtim me nenin 6, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, klasifikohet me status të veçantë, dhe marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me akte të veçanta të nxjerra nga Akademia e Drejtësisë.

Ndërsa, sa i përket cilësisë së shërbimeve administrative, si dhe shpenzimeve financiare të administratës dhe shërbimeve të përgjithshme, sfiduese ka vazhduar të mbetet buxheti i pamjaftueshëm, mungesa e investimeve kapitale, si dhe zbatimi i legjislacionit të ri dhe i procedurave në SIMBNJ për zyrtarët publik. Ndërsa, një sfidë e pakalueshme vazhdon të jetë ndarja e buxhetit për funksionalizimin e ndërtesës së re të Akademisë së Drejtësisë. Përkundër kërkesave buxhetore dhe paraqitjes së nevojës gjatë dëgjimeve buxhetore, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar të informojë Ministrinë e Financave për nevojën urgjente për planifikim dhe ndarje të mjeteve të domosdoshme për inventar, pajisje dhe funksionalizim të plotë të ndërtesës.

Në kuadër të ngritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, respektivisht bashkëpunimit me donatorë, projekte dhe organizata ndërkombëtare, në vitin 2025 është shënuar një rënie e konsiderueshme e mbështetjes së donatorëve dhe projekteve të mbështetura nga institucionet ndërkombëtare.

Vizioni dhe misioni

Akademia e Drejtësisë është një institucion publik i pavarur, i mandatuar me ligj për edukimin, trajnimin dhe zhvillimin profesional të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe të profesionistëve të tjerë të sistemit të drejtësisë.

Akademia e Drejtësisë, si një nga institucionet kryesore të sistemit të drejtësisë, ka për mision forcimin e cilësisë, profesionalizmit dhe pavarësisë së këtij sistemi, përmes zhvillimit të kapaciteteve profesionale dhe institucionale, promovimit të standardeve të larta etike dhe avancimit të praktikave bashkëkohore gjyqësore e prokuroriale.

Në këtë drejtim, Akademia e Drejtësisë ofron programe trajnuese të dizajnuara sipas nevojave reale të sistemit të drejtësisë, të dedikuara për gjyqtarë, prokurorë, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe për profesionistë të tjerë të sistemit të drejtësisë. Gjithashtu, në kuadër të mandatit të saj, harton analiza profesionale, zhvillon hulumtime dhe realizon veprimtari botuese, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

1. Rëndësia e Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2026

Plani i Punës dhe i Performancës është një dokument thelbësor, i cili paracakton me detaje veprimtarinë institucionale në përmbushje të objektivave vjetore. Ky plan hartohet dhe miratohet nga institucionet përkatëse brenda afateve të paracaktuara, në përputhje me Rregulloren Nr. 12/2023 mbi sistemin e menaxhimit të performancës për agjencitë dhe institucionet e administratës shtetërore, duke përfshirë edhe agjencitë e pavarura të themeluara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Referuar nenit 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje, Plani i Punës dhe i Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026 përmban pesë objektiva kryesore, të zbërthyera në nënobjektiva dhe veprime për secilin Departament dhe Divizion përgjegjës. Objektivat janë të matshme dhe në përputhje me prioritetet e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, për aftësimin dhe avancimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe profesionistët e tjerë ligjorë, në përputhje me mandatin ligjor të Akademisë.

Ky plan paraqet instrumentin kryesor strategjik që orienton veprimtarinë vjetore të Akademisë së Drejtësisë, duke përcaktuar objektivat, proceset e punës dhe hapat e nevojshëm për realizimin e rezultateve të parashikuara sipas indikatorëve matës. Për më tepër, Plani i Punës dhe i Performancës siguron një drejtim të qartë për departamentet dhe divizionet brenda institucionit, duke krijuar një strukturë funksionale për planifikimin, implementimin dhe monitorimin e aktiviteteve. Njëkohësisht, plani përcakton rolin, përgjegjësitë dhe angazhimin e resurseve institucionale që do të përfshihen në aktivitetet përkatëse për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara.

Për realizimin e plotë të këtij plani, Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në menaxhimin efektiv të punës, si dhe në koordinimin dhe ndërlidhjen e programeve dhe shërbimeve që ofron në përputhje me mandatin ligjor. Gjithashtu, Akademia e Drejtësisë do të sigurojë koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me KGJK-në, KPK-në, kryetarët e gjykatave, kryeprokurorët e prokurorive, trajnuesit, partnerët zhvillimorë dhe mbështetës, me qëllim që përfituesit e programeve trajnuese të fuqizojnë kapacitetet profesionale dhe ndërdisiplinore, si dhe të rrisin performancën në ushtrimin e funksioneve të tyre.

2. Baza ligjore dhe funksionet e Akademisë

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, si dhe në Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, Akademia e Drejtësisë është një institucion publik i

pavarur, me mandat dhe kompetenca të qarta ligjore në fushën e zhvillimit profesional dhe ngritjes së kapaciteteve të sistemit të drejtësisë.

Në pajtim me nenin 6 të Ligjit Nr. 05/L-095, funksionet kryesore të Akademisë së Drejtësisë përfshijnë:

- Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit
 - Hartimi i programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - Organizimi i trajnimeve për këto kategori në përmbushje të mandatit të saj ligjor.
- Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për trajnim
 - Zhvillimi i procesit të vlerësimit të nevojave për trajnime përmes mekanizmave të përcaktuar nga Akademia.
 - Harmonizimi i planifikimit të trajnimeve me kërkesat e KGJK-së dhe KPK-së.
- Trajnimi i stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial
 - Organizimi i trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, pas koordinimit paraprak me KGJK-në dhe KPK-në, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- Trajnimi i profesioneve të lira që lidhen me sistemin e drejtësisë
 - Mundësinë e organizimit të trajnimeve të vazhdueshme profesionale për avokatinë shtetërore, avokatë, noterë, përmbarues privatë, ndërmjetësues, administratorë të falimentimit dhe profesione të tjera të ngjashme, sipas vlerësimit të Akademisë dhe kërkesave të institucioneve kompetente.
- Zbatimi i programeve trajnuese në bashkëpunim institucional
 - Zbatimi i programeve trajnuese në bashkëpunim me KGJK-në, KPK-në, Odat profesionale dhe institucionet përkatëse.
- Administrimi i sistemit të të dhënave dhe dokumentacionit të trajnimeve
 - Vendosjen dhe mirëmbajtjen e sistemit të të dhënave për programet dhe aktivitetet trajnuese në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- Bashkëpunimi ndërinstitucional në nivel vendor dhe ndërkombëtar
 - Krijimin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e bashkëpunimit me institucione vendore dhe të huaja të ngjashme me veprimtarinë e Akademisë, duke përfshirë praktikantë profesionale, programet e shkëmbimit dhe aktivitetet e tjera të interesit të përbashkët.
- Zhvillimi i analizave dhe hulumtimeve profesionale
 - Zhvillimi i analizave, hulumtimeve dhe bashkëpunimin me institucionet shkencore për përkrahjen e sistemit të drejtësisë dhe zhvillimin profesional.
- Veprimtaria botuese
 - Realizimi i botimeve profesionale për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, përfshirë materiale, udhëzues dhe dokumente tjera të nevojshme ligjore.

Pra, vija llogaridhënëse e Akademisë së Drejtësisë, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, mandaton Këshillin Drejtues si subjektin e vetëm të raportimit dhe llogaridhënies. Kjo garanton funksionimin e Akademisë në përputhje me parimet e pavarësisë, transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale.

Përveç legjislacionit bazë, funksionimi i Akademisë së Drejtësisë mbështetet edhe në aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli Drejtues i saj, si më poshtë:

1. Rregullore Nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;

2. Rregullore Nr. 02/2023 për Plotësim-Ndryshmin e Rregullores Nr. 02/2017 për Punën e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë;
3. Rregullore Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
4. Rregullore Nr. 03/2023 për Plotësim-Ndryshmin e Rregullores Nr. 04/2017 për Punën e Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë;
5. Rregullore Nr. 05/2017 për Tarifat e Trajnimeve për Avokatinë e Shtetit, Avokatë dhe Profesione të Tjera të Lira;
6. Rregullore Nr. 02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë;
7. Rregullore Nr. 01/2023 për Plotësim-Ndryshmin e Rregullores Nr.02/2019 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë.
8. Rregullore Nr. 02/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e rregullores nr. 01/2023 për Trajnuesit dhe Mentorët e Akademisë së Drejtësisë
9. Rregullore Nr. 04/2023 për Pranimin dhe Emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë;
10. Rregullore Nr.05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë
11. Rregullore Nr. 01/2025 për Plotësim-Ndryshimin e rregullores nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Akademinë e Drejtësisë.

Projektligji për Akademinë e Drejtësisë është aktualisht në proces të ndryshimit dhe plotësimit, dhe si i tillë, përkundër agjendës legislative, ende nuk ka kaluar në Kuvend për shqyrtim dhe miratim. Plani i Punës dhe i Performancës është hartuar mbi bazën aktuale ligjore, dhe çdo ndryshim eventual që rrjedh nga hyrja në fuqi e ligjit të ri, i cili mund të ndikojë në Planin e Punës dhe të Performancës, do të rishikohet dhe përditësohet në përputhje me rrethanat.

3. Organet e Akademisë së Drejtësisë

Organet udhëheqëse të Akademisë së Drejtësisë në Republikën e Kosovës përbëhen nga Këshilli Drejtues, Këshilli Programor dhe Drejtori Ekzekutiv, të cilët së bashku sigurojnë funksionimin strategjik, administrativ dhe profesional të institucionit.

Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës dhe përbëhet nga nëntë anëtarë, përfshirë edhe Kryesuesin, me mandat për të udhëhequr dhe orientuar qasjen strategjike të Akademisë, për të miratuar politikat programore, planin vjetor të punës, buxhetin dhe raportet e performancës, si dhe për të mbikëqyrur zbatimin e standardeve të qeverisjes së mirë.

Këshilli Programor, si organ profesional këshillëdhënës, kryesohet ex officio nga Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë. Ky këshill ka rol thelbësor në hartimin, zhvillimin dhe përditësimin e programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, në harmonizim me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për formimin profesional në sistemin e drejtësisë. Ai siguron cilësinë profesionale të programeve, propozon metodologjitë e trajnimit dhe kontribuon në garantimin e zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë të sistemit të drejtësisë.

Drejtori Ekzekutiv është udhëheqësi më i lartë dhe përgjegjës kryesor administrativ i Akademisë së Drejtësisë, dhe për punën e tij është përgjegjës ndaj Këshillit Drejtues.

Gjithashtu, Drejtori mbikëqyr menaxhimin efikas të proceseve të brendshme institucionale, rekrutimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e personelit, organizimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit, koordinimin e aktiviteteve ndër-institucionale dhe zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues, duke siguruar funksionim të rregullt, transparent dhe të përgjegjshëm.

3.1 Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë

Këshilli Drejtues i Akademisë, në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë dhe Ligjin Nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që lidhen me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura, është organi kryesor ndaj të cilit Akademia e Drejtësisë raporton punën e saj. Ky këshill përbëhet nga nëntë anëtarë, përfshirë edhe Kryesuesin, dhe siguron përfaqësim të institucioneve të drejtësisë dhe ekzekutivit, duke përfshirë edhe përfaqësimin etnik. Përbërja e tij garanton një përfaqësim gjithëpërfshirës dhe të drejtë të interesave të akterëve të sistemit të drejtësisë në Kosovë, duke siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e Akademisë, në funksion të interesit më të mirë të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në vend.

Këshilli Drejtues, si organi më i lartë i Akademisë së Drejtësisë, për vitin 2026 do të fokusohet, ndër të tjera, në shqyrtimin dhe miratimin e çështjeve si më poshtë:

- Raportin vjetor të punës dhe të Performancës për vitin 2025, si dhe raportin financiar për 2025
- Miratimin e listës e trajnuesve të përkohshëm, si dhe angazhimin e tyre në zbatim të programeve trajnuese;
- Miratimin e listës së mentorëve për gjeneratat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar në kuadër të trajnimit fillestar;
- Projektbuxhetin e Akademisë së Drejtësisë;
- Shqyrtimin e kërkesave të KGK-së dhe KPK-së për fillimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët që janë në proces të rekrutimit;
- Programet e trajnimit Fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar;
- Programin Vjetor të Trajnimeve të Vazhdueshme për vitin 2027;
- Programin e Hulumtimeve dhe Botimeve të Akademisë së Drejtësisë
- Planin e Punës dhe të Performancës për vitin 2027 si dhe çështje tjera që mund të paraqiten në përputhje me zhvillimet gjatë vitit 2026;
- Raportin e performancës së trajnuesve të angazhuar në programet trajnuese;
- Shqyrtimin dhe miratimin e rregulloreve për nëpunësit civil me status të veçantë të Akademisë së Drejtësisë;
- Shqyrtimin dhe miratimin e Strategjisë Institucionale të Akademisë së Drejtësisë.

3.2 Këshilli Programor i Akademisë së Drejtësisë

Këshilli Programor është organ profesional i cili angazhohet për të siguruar cilësinë e trajnimeve të ofruara nga Akademia e Drejtësisë. Ky këshill udhëhiqet dhe kryesohet nga Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë dhe përbëhet nga gjyqtarë, prokurorë të shtetit dhe ekspertë të tjerë, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues.

Këshilli Programor, si organ profesional, do të angazhohet në hartimin e programeve trajnuese, vlerësimin e performancës së trajnerëve të angazhuar, shqyrtimin e listës së trajnerëve dhe dhënien e rekomandimeve për Këshillin Drejtues. Për vitin 2026, aktiviteti kryesor i Këshillit Programor do të fokusohet në çështjet si ne vijim:

- Hartimin e programeve të trajnimit të Akademisë së Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK)-në dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK-në);
- Rekomandimin e listës së trajnuesve të përkohshëm të përzgjedhur përmes procedurës së rekrutimit;
- Rishqyrtimin dhe vlerësimin e raportit të performancës së trajnuesve të angazhuar nga Akademia e Drejtësisë, në zbatim të programeve trajnuese gjatë vitit 2026;
- Shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit Vjetor të Nevojave për Trajnim
- Shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit të Trajtimeve
- Ofrimin e orientimeve dhe këshillave profesionale për avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese;
- Dhënien e propozimeve për përmirësimin e cilësisë së trajnimeve të Akademisë së Drejtësisë.

3.3 Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë

Drejtori Ekzekutiv, si udhëheqësi më i lartë dhe përgjegjës kryesor administrativ i Akademisë së Drejtësisë, përgjegjës për menaxhimin efikas të proceseve të brendshme institucionale, rekrutimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e personelit, organizimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit, koordinimin e aktiviteteve ndërinstitucionale dhe zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues, do të angazhohet në prioritet si më poshtë:

- Përfaqësimin e Akademisë së Drejtësisë në institucione vendore dhe ndërkombëtare, në takime zyrtare, konferenca, forume profesionale dhe iniciativa bashkëpunimi;
- Kryesimin e takimeve të Këshillit Programor të AD-së
- Zhvillimin dhe forcimin e partneriteteve strategjike me KGJK-në, KPK-në, Gjykatat, Prokuroritë, institucionet e tjera të drejtësisë, organizatat ndërkombëtare dhe partnerët zhvillimor;
- Nismat dhe aktivitetet në nxitjen e bashkëpunimeve të reja për projekte të përbashkëta, asistencë teknike dhe ngritje të kapaciteteve në përputhje me nevojat zhvillimore të sistemit të drejtësisë;
- Menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punës së përgjithshme të AD-së, duke siguruar funksionim efikas, të koordinuar dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi;
- Mbikëqyrje e zbatimit të procedurave të brendshme administrative, financiare dhe profesionale;
- Sigurimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, transparencës dhe respektimit të standardeve të integritetit institucional;
- Sigurimin e zbatimit të vendimeve, udhëzimeve dhe kërkesave të Këshillit Drejtues;
- Propozimin e projektbuxhetit vjetor të Akademisë, në bazë të planifikimit programor, nevojat zhvillimore dhe kërkesat institucionale;
- Propozimin e Strategjisë institucionale, Planit të punës dhe Programin Vjetor për

Trajnime të vazhdueshme si dhe Programeve e Trajnimit Fillestar të Akademisë së Drejtësisë;

- Propozimin listës së trajnuesve të përkohshëm si dhe rekomandimet e Këshillit Programor për miratim nga Këshilli Drejtues;
- Propozimin e listës së trajnuesve për angazhim në zbatim të programeve trajnuese për miratim nga Këshilli Drejtues;
- Sigurimin e ndërtimit të kapaciteteve profesionale të trajnuesve dhe përfshirjen e ekspertëve të jashtëm sipas nevojës;
- Menaxhimin e mjeteve financiare dhe pronës së AD-së dhe kryerjen aktiviteteve tjera në përputhje me mandatin;
- Propozimin e Projekt-Rregulloreve për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, Projekt-Rregullores mbi përzgjedhjen e trajnuesve, Projekt-Rregullores e punës së Këshillit Drejtues dhe Projekt-Rregulloren e punës së Këshillit Programor, si dhe aktet tjera nënligjore të cilat parashihen me plotësim ndryshimin e Ligjit për Zyrtarët Publik, respektivisht të gjitha aktet nënligjore të cilat rregullojnë marrëdhënien e punës për nëpunësit civilë me status të veçantë;
- Përgatitjen dhe prezantimin e raporteve vjetore të rregullta si dhe raporte të tjera sipas kërkesës së Këshillit Drejtues.

I. Objektivat e përgjithshme të Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2026

1. Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar;
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor e prokurorial, si dhe profesionistëve të tjerë ligjorë;
3. Zhvillimi i programeve trajnuese, ngritja e cilësisë së trajnimeve, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese;
4. Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me partnerët vendor, donatorët dhe institucionet trajnuese ndërkombëtare;
5. Ngritja e kapaciteteve profesionale administrative, cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit.

1. Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar

Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj në trajnimin fillestar synon ndërtimin e bazës ligjore, etike dhe praktike për ushtrimin me përgjegjësi të funksionit. Ky plan ka për qëllim zbatimin e veprimtarisë trajnuese për vitin 2026, duke siguruar zhvillimin e njohurive teorike dhe aftësive praktike të nevojshme për ushtrimin profesional dhe të përgjegjshëm të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale. Procesi i zhvillimit të programit dhe planifikimit garanton përputhshmërinë e programeve me standardet profesionale të kërkuara nga sistemi i drejtësisë dhe krijon bazën për integrimin e kandidatëve në detyrat dhe përgjegjësitë profesionale që i presin.

Bazuar në programin dhe kalendarin trajnues, për 21 gjyqtarët e gjeneratës XIII-të do të vazhdojë zbatimi i trajnimit praktik në gjykatat përkatëse të emërimit deri në muajin maj 2026. Gjatë kësaj periudhe, gjyqtarët do të mbikëqyren nga mentorët e caktuar nga AD-ja, të cilët në baza javore do të raportojnë për ecurinë dhe zhvillimet e trajnimit. Në përfundim të trajnimit praktik, gjyqtarët do t'i nënshtrohen provimit përfundimtar.

Paralelisht, Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë zbatimin e trajnimit fillestar edhe për gjeneratën XI-të të prokurorëve, përkatësisht 24 prokurorë të sapoemëruar, të cilët pritet të përfundojnë trajnimin në shkurt të vitit 2026. Ky trajnimi ka filluar në janar të vitit 2025 dhe vazhdon deri në shkurt të vitit 2026. Në përfundim të trajnimit teorik dhe praktik, prokurorët do t'i nënshtrohen provimit përfundimtar.

Krahas dy gjeneratave të lartpërmendura, në nëntor 2025 ka filluar trajnimi fillestar i gjeneratës XIV-të të gjyqtarëve të sapoemëruar, i cili do të vazhdojë gjatë vitit 2026. Akademia ka miratuar programin pas procesit të vlerësimit të nevojave, në bashkëpunim me KGJK-në. Në të njëjtën kohë, pritet rekrutimi i 21 prokurorëve të rinj (gjenerata XII-të), për të cilët KPK kishte përfunduar procesin e përzgjedhjes, por nga zhvillimet e fundit, ky proces është anuluar tërësisht. Programi për këtë gjeneratë është hartuar dhe miratuar nga Akademia pas vlerësimit të nevojave trajnuese në bashkëpunim me KPK-në, dhe realizimi i tij do të varet nga zhvillimet gjatë vitit 2026.

Gjatë vitit 2026, KGJK ka planifikuar një proces të ri rekrutimi për një grup të ri prej 21 gjyqtarësh të rinj, që përbëjnë gjeneratën XV-të. Sipas planifikimeve, ata pritet të fillojnë trajnimin në pjesën e parë të vitit 2026. Akademia e Drejtësisë do të monitorojë të gjitha zhvillimet lidhur me rekrutimet e reja dhe, në bashkëpunim me KGJK-në dhe Këshillin Programor, do të përditësojë programin trajnues sipas nevojës.

Për vitin 2026, Programi i Trajnimit Fillestar do të fokusohet në arritjen e nën-objektivave kryesore, të cilat paraqiten më poshtë:

1.1 Zbatimi i trajnimit praktik për 21 gjyqtarë të sapoemëruar të gjeneratës XIII, në gjykata, nën mbikëqyrjen e gjyqtarëve mentorë;

1.2 Zbatimi i trajnimit fillestar, duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik, për 24 prokurorë të sapoemëruar të gjeneratës XI;

1.3 Zbatimi i trajnimit fillestar, duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik, për 20 gjyqtarë të sapoemëruar të gjeneratës XIV;

1.4 Zbatimi i trajnimit fillestar, duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik, për 20 prokurorë të sapoemëruar të gjeneratës XII;

1.5 Zbatimi i trajnimit fillestar për 20 gjyqtarë të sapoemëruar të gjeneratës XV, si dhe për 8 gjyqtarë nga komuniteti serb.

1.1. Zbatimi i trajnimit fillestar për 21 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së XIII

Programi për këtë gjeneratë ka filluar më 18 prill 2025 dhe pritet të përfundojë më 24 maj 2026. Bazuar në strukturën dhe kalendarin e këtij programi, kjo gjeneratë do të vazhdojë trajnimin praktik në fushat civile dhe penale. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, provimi përfundimtar dhe rezultatet e tij përbëjnë përmbylljen e programit fillestar për këtë gjeneratë. Paneli për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përfundimtar do të angazhohet në përgatitjen dhe vlerësimin e provimit, ndërsa stafi përgjegjës i programit do të angazhohet në

përmbledhjen e vlerësimeve për detyrat dhe angazhimet e gjyqtarëve gjatë trajnimit fillestar, si dhe në përgatitjen e raportit përfundimtar për gjyqtarët e kësaj gjenerate, i cili do të dërgohet në KGJK, respektivisht për Komisionin e Vlerësimit të Performancës.

1.2. Zbatimi i trajnimit fillestar për 24 prokurorët e sapoemëruar, gjenerata e XI

Ky grup prokurorësh të sapoemëruar përbën gjeneratën e XI-të në trajnimin fillestar të Akademisë së Drejtësisë, e cila do të vazhdojë trajnimin teorik dhe praktik deri në shkurt të vitit 2026. Modulet që do të realizohen në kuadër të trajnimit teorik janë si më poshtë:

- Kodi i Procedurës Penale
- Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese

Paralelisht me trajnimin teorik, prokurorët do të zhvillojnë edhe trajnimin praktik në prokuroritë përkatëse ku janë emëruar. Trajnuesit dhe mentorët do të vazhdojnë angazhimin e tyre në zbatimin e trajnimeve fillestare. Sipas strukturës së këtij programi, pas përfundimit të sesioneve teorike dhe praktike, do të organizohet provimi përfundimtar, i cili shënon përmbylljen e programit fillestar për këtë gjeneratë të prokurorëve. Ngjashëm si për gjeneratat paraprake, Paneli për Hartimin dhe Vlerësimin e Provimit Përfundimtar do të angazhohet në hartimin dhe vlerësimin e provimit, ndërsa stafi përgjegjës i programit do të përmbledhë vlerësimet për detyrat dhe angazhimet e prokurorëve gjatë trajnimit fillestar dhe do të përgatisë raportin përfundimtar për secilin prej tyre, që do t'i dërgohet KPK-së, përkatësisht Komisionit të Vlerësimit të Performancës.

1.3. Zbatimi i trajnimit fillestar duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik për 20 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së XIV

Kjo gjeneratë ka filluar trajnimin fillestar më 17 nëntor 2025 dhe pritet të përfundojë më 24 dhjetor 2026. Akademia e Drejtësisë, sipas programit trajnues për këtë gjeneratë, ka filluar trajnimin në fushën penale. Në kuadër të trajnimit teorik do të realizohen modulet Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtar, Shkathtësitë Personale dhe Ndërpersonale, Legjislacioni dhe Shkathtësitë Plotësuese, si dhe E Drejta Civile, Ekonomike dhe Administrative. Pas përfundimit të trajnimit teorik në secilën fushë do të zbatohet trajnimi praktik në gjykatat përkatëse ku janë emëruar.

1.4. Zbatimi i trajnimit fillestar duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik për 20 prokurorë të sapoemëruar të gjeneratës së XII

Akademia ka vlerësuar programin trajnues dhe strukturën e zbatimit të tij, ku në bashkëpunim me KPK dhe Këshillin Programor është rekomanduar që realizimi i trajnimit për këtë gjeneratë të zbatohet me 6 muaj trajnim teorik dhe 6 muaj trajnim praktik. Këshilli Drejtues ka mirëpritur këtë rekomandim dhe e ka aprovuar atë. Në vijim, AD ka ndërmarrë të gjitha përgatitjet, duke përfshi kalendarin trajnues dhe materialet tjera përcjellëse, por në fund Këshilli Prokurorial,

edhe pse ishte në përfundim të procesit të rekrutimit, ka anuluar të gjithë procesin. Kështu, planifikimi i realizimit të programit trajnues për këtë gjeneratë nga AD do të fillojë në momentin e përfundimit të procesit të rekrutimit nga KPK, i cili parashihet të realizohet në vitin 2026.

1.5. Zbatimi i trajnimit fillestar për 20 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së XV dhe 8 gjyqtarë të komunitetit serb

Akademia e Drejtësisë, përveç planifikimit për gjeneratat e lartpërmendura, në planin e punës ka parashikuar edhe trajnimet fillestare për gjeneratat të tjera, përkatësisht gjeneratën e XV-të të gjyqtarëve, meqë sipas zhvillimeve në KGJK priten rekrutime të reja. KGJK, më 09 shtator 2025, ka shpallur një konkurs për pozitat e rezervuara (8) për gjyqtarët nga komuniteti serb. Sipas parashikimeve, kjo gjeneratë mund të fillojë zbatimin e trajnimit fillestar në tremujorin e dytë të vitit 2026.

Duke përcjellë këto zhvillime sa i përket rekrutimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj, AD do të angazhohet së bashku me KGJK-në, KPK-në dhe Këshillin Programor në hartimin dhe përditësimin e programit fillestar.

2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor e prokurorial, si dhe profesionistëve të tjerë ligjorë

Avancimi i kapaciteteve profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve të tjerë ligjorë është thelbësorë për sigurimin e një sistemi gjyqësor efikas, të drejtë dhe etik. Trajnimi i vazhdueshëm përbën objektivin kryesor, ku synohet të forcohen jo vetëm njohuritë juridike, por edhe shkathtësitë analitike, komunikative dhe menaxhuese të përfituesve, duke ndërthurur aspektin teorik dhe praktik, me qëllim që zbatimi i ligjit të jetë sa më profesional dhe i unifikuar. Përmes një qasjeje të tillë, fuqizohet roli i secilit akter në garantimin e sundimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këshilli Programor, si organ profesional, ka hartuar draft-programin vjetor për trajnime të vazhdueshme, duke përcaktuar objektivat, përfituesit, metodologjinë dhe kohëzgjatjen, dhe ka rekomanduar Këshillin Drejtues për miratim. Në takimin e Këshillit Drejtues të datës 03 nëntor 2025, është miratuar Programi Vjetor për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2026, i cili gjithashtu është publikuar.

Duke iu referuar Programit Vjetor për Trajnime të Vazhdueshme, gjithsej janë të përfshira 194 aktivitete trajnuese me një kohëzgjatje prej 214 ditësh trajnimi. Programi Vjetor për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2026, si i miratuar nga Këshilli Drejtues, përfshin 84 aktivitete trajnuese për gjyqtarë dhe prokurorë, të ndara sipas fushave që përfshijnë çështje penale, veçanërisht për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, sekuestrimin dhe konfiskimin, format e tjera të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, dhunën në familje, aspektin e të drejtave të njeriut; çështje administrative, veçanërisht për konfliktin administrativ; çështje civile, veçanërisht për procedurat gjyqësore në çështje kontestimore dhe jo kontestimore; drejtësinë për fëmijë; drejtësinë komerciale; si dhe çështjet tjera që janë sfiduese për praktikën gjyqësore. Përveç kësaj, janë përfshirë edhe dy trajnime për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive.

Fusha e gjerë tematike e këtyre trajnimeve adreson si nevojat aktuale, ashtu edhe sfidat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial, duke mundësuar specializim më të thelluar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fusha të caktuara dhe duke rritur cilësinë e vendimmarrjes profesionale. Gjithashtu, përcaktimi i qartë i objektivave dhe metodologjisë siguron standardizim dhe vazhdimësi në zbatimin e programeve trajnuese.

Ndërsa, sikurse edhe gjatë vitit 2025, krahas 83 aktiviteteve trajnuese të dedikuara për gjyqtarët dhe prokurorët, për vitin 2026, në Programin Vjetor të Trajnimeve të Vazhdueshme janë planifikuar të realizohen edhe 110 aktivitete trajnuese për bashkëpunëtorët profesionalë dhe stafin tjetër mbështetës administrativ të gjykatave dhe prokurorive, duke përfshirë 76 trajnime për bashkëpunëtorët profesionalë (75 për module bazike civile dhe penale dhe 1 për drejtësinë tranzicionale), 21 trajnime fillestare dhe të vazhdueshme për stafin administrativ gjyqësor, si dhe 13 trajnime fillestare dhe të vazhdueshme për stafin administrativ prokurorial. Në aktivitetet trajnuese të përbashkëta me gjyqtarët dhe prokurorët do të përfshihen edhe profesionistë të tjerë ligjorë, si ndërmjetësuesit, përmbaruesit, mbrojtësit e viktimave dhe zyrtarët e ndihmës juridike falas. Andaj, trajnimet e vazhdueshme për vitin 2026, do të fokusohen në nën-objektivat specifike si në vijim:

- 2.1 Zbatimin e trajnimeve në përputhje me Planin e Veprimit të Strategjisë për Sundimin e Ligjit 2024–2026 dhe dokumentet e tjera strategjike relevante;
- 2.2 Zbatimin e trajnimeve në përputhje me prioritetet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), si dhe bazuar në nevojat trajnuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- 2.3 Organizimin dhe zbatimin e tryezave për unifikimin e praktikës gjyqësore;
- 2.4 Zbatimin e trajnimeve për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive;
- 2.5 Zbatimin e trajnimeve për bashkëpunëtorët profesionalë dhe zyrtarët ligjorë të gjykatave dhe prokurorive;
- 2.6 Zbatimin e trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial;
- 2.7 Zbatimin e trajnimeve për profesionet e lira, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 2.8 Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas vlerësimit të Performancës
- 2.9 Zbatimin e trajnimeve përmes platformave të mësimit në distancë, sipas nevojës dhe kërkesave institucionale.
- 2.10 Zbatimi i trajnimit të trajnuesve sipas metodologjisë së përcaktuar në Doracakun për Trajnues
- 2.11 Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2027

2.1 Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026, përkatësisht Plani i Veprimit për vitin 2024-2026

Përcakton një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve dhe trajnimeve që duhet të përfshihen në Planin e punës dhe të performancës së AD-së. Ato janë mandatore për programin trajnues të AD-së, prandaj si të tilla do të jenë prioritet për AD-në dhe do të vazhdohet sipas ecurisë dhe planit të përcaktuar për secilën prej tyre. Sipas strategjisë janë 33 masa/aktivitete, prej të cilave të përmbledhura janë si në vijim:

- Ofrimin e trajnimeve të specializuara në fushën e menaxhimit dhe udhëheqjes, për kryetarët e gjykatave, kryeprokurorët, gjyqtarët mbikëqyrës dhe kandidatët në pozita drejtuese;
- Vlerësimin e ndikimit të trajnimeve në sistemin gjyqësor dhe prokurorial i realizuar gjatë 3-5 viteve të fundit;

- Ofrimin e trajnimeve të specializuara për gjyqtarët në fusha të specializuara të së drejtës komerciale;
- Ofrimin e trajnimeve të specializuara për gjyqtarët në fushat e identifikuar si nevojë për përmirësim gjatë vlerësimit të performancës;
- Realizimin e një analize mbi nevojën për specializim të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) në bashkëpunim me AD-në;
- Rishikimin i programit të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor;
- Zgjerimin i Platformës Elektronike të Akademisë së Drejtësisë, me qëllim të përfshirjes së moduleve shtesë të trajnimeve online;
- Ofrimin e trajnimeve për të gjithë anëtarët e Komisionit të Rekrutimit për gjyqtarë dhe prokurorë;
- Ofrimin e trajnimeve për njësinë e verifikimit të KGJK-së me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale në procesin e verifikimit;
- Ofrimin e trajnimeve të specializuara për prokurorët dhe gjyqtarët, si dhe hetuesit në njësinë për hetimin e krimeve të luftës, lidhur me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës;
- Zhvillimin e programit të ri trajnues për gjyqtarët dhe prokurorët për drejtësinë për të mitur, në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore;
- Organizimin e trajnimeve për gjyqtarët lidhur me trajtimin e rasteve nga lëmia civile përfshirë shkurorëzimin, alimentacionin, fëmijët pa përkujdesje prindërore dhe adoptimin;
- Ofrimin e trajnimeve lidhur me kompetencat e zgjeruara të konfiskimit;
- Ofrimin e trajnimeve për gjyqtarët dhe ndërmjetësuesit, lidhur me unifikimin e praktikave të pranimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit dhe trajnime në fushën civile, familjare dhe pronësore;
- Hartimi i kurrikulës dhe ofrimi i trajnimeve bazike dhe të specializuara për gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Komerciale;
- Ofrimin e trajnimeve për zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF), lidhur me paraqitjen e padive në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe Kodit të ardhshëm të Procedurës Civile;
- Përgatitjen e kurrikulës së trajnimit për Ligjin e ri për Konfliktet Administrative dhe organizimin e trajnimeve për gjyqtarët, zyrtarët e ANJF-së dhe avokatët shtetërorë;
- Ofrimin e trajnimeve për procedurat e falimentimit.

Për këto masa, periudha kohore e realizimit është deri në fund të vitit 2026, andaj Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në zbatimin e aktiviteteve trajnuese për të cilat është institucion përgjegjës. Ndërkaq, për ato masa ku AD është institucion mbështetës i KGJK-së, KPK-së ose institucioneve të tjera të drejtësisë, pritet që iniciativa udhëheqëse të vijë nga këto institucione, meqë roli i AD-së është mbështetës. Disa nga aktivitetet sipas kësaj strategjie, ku AD është institucioni mbështetës, përfshijnë kryesisht trajnime të dedikuara komisioneve dhe organeve, veprimtaria e të cilëve lidhet me vlerësimin e performancës, verifikimin e çështjeve dhe aktivitete të tjera që janë pjesë e punës së KGJK-së dhe KPK-së. Realizimi i këtyre aktiviteteve do të mundësohet përmes ekspertizës së jashtme, pasi AD nuk ka përvojë paraprake në këtë fushë.

Programi për mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave të Njeriut synon gjithashtu rritjen e profesionalizmit dhe kompetencës së gjyqtarëve dhe prokurorëve në lidhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë te liria e shprehjes, gjuhë e urrejtjes, liria e medias dhe mbrojtja e gazetarëve për sinjalizim, në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës.

Sipas këtij programi, parashihen 6 masa/aktivitetet kryesore, të cilat përmbledhen si më poshtë:

- Trajnimi në procedurën penale, me fokus te çështjet që përfshijnë personat me çrregullime mendore;
- Trajnimi për rastet e dhunës në baza gjinore, dhunës në familje dhe ngacmimit seksual, me qasje të përqendruar te viktimat;
- Trajnimi për mosdiskriminimin;
- Trajnimi për praktikën dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut;
- Trajnimi për lirinë e shprehjes, gjuhën e urrejtjes, lirinë e medias dhe për sinjalizimin e gazetarëve, në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës;
- Trajnimi për ndarjen e pasurisë së përbashkët pas shkurorëzimit, përfshirë alimentacionin dhe mbajtjen financiare të bashkëshortit/ës.

Një pjesë e konsiderueshme e këtyre aktiviteteve do të realizohen me mbështetjen e donatorëve, veçanërisht përmes projekteve të Këshillit të Evropës.

Strategjia për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022–2026 synon gjithashtu rritjen e profesionalizmit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje, përfshirë edhe rastet ku kryesit vuajnë nga çrregullime mendore. Në këtë kontekst, Plani i Punës dhe i Performancës së Akademisë së Drejtësisë do të ketë si prioritet organizimin e trajnimeve në këtë fushë.

Bazuar në kërkesat e këtij dokumenti strategjik, parashihen 7 sesione trajnuese për dhunën në familje (për aspektin penal dhe civil), si dhe 2 sesione trajnuese për rastet që përfshijnë kryesit me çrregullime mendore.

Falë bashkëpunimit me Këshillin e Evropës, përmes Projektit “Përafrimi i Legjislacionit me Konventën e Stambollit”, është rishikuar kurrikula e trajnimit dhe, mbi këtë bazë, janë përgatitur edhe modulet trajnuese.

Këto trajnime pritet të kontribuojnë në zhvillimin e një qasjeje më të ndjeshme ndaj viktimave dhe në zbatim më konsekuent të standardeve ndërkombëtare. Përmes tyre, gjyqtarët dhe prokurorët do të pajisen me mjete praktike për trajtimin e rasteve komplekse që lidhen me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Në këtë mënyrë, roli i sistemit të drejtësisë në parandalimin dhe sanksionimin e dhunës forcohet dhe konsolidohet më tej.

2.2 Zbatimi i trajnimeve sipas prioriteteve të KGJK-së dhe KPK-së si dhe nevojave trajnuese të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë përkushtimin e saj në përmbushjen e kërkesave dhe prioriteteve të KGJK-së dhe KPK-së, me fokus kryesor në zbatimin e trajnimeve të detyrueshme që rrjedhin nga obligimet ligjore dhe aktet nënligjore të këtyre institucioneve, sipas nevojës dhe kërkesave të tyre.

Trajnimet për gjyqtarë dhe prokurorë do të zhvillohen në përputhje me propozimet e Programit Trajnues 2026, ndërsa trajnimet për stafin administrativ gjyqësor do të realizohen sipas kërkesave ekskluzive të KGJK-së.

Bazuar në kërkesat e KGJK-së, aktivitetet trajnuese për gjyqtarë do të zhvillohen me metodologjinë e preferuar të tryezave të diskutimit, si forma më e përshtatshme për adresimin e sfidave dhe problemeve praktike në sistemin gjyqësor.

2.3 Realizimi i trajnimeve përmes tryezave për adresimin e problemeve praktike dhe çështjeve nga praktika gjyqësore

Tryezat për unifikimin e praktikës gjyqësore vazhdojnë të jenë efektive dhe të preferuara nga pjesëmarrësit edhe për vitin 2026, duke u konsideruar si një nga format më të përshtatshme për avancimin e njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në fusha dhe tema të caktuara.

Në kuadër të këtij plani, janë përfshirë tryezat dhe konferencat (penale, civile, administrative, KEDNJ). Produkt i këtyre tryezave do të jenë konkluzionet për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe, sipas nevojës, hartimi i doracakëve, udhëzuesve ose formave të tjera, të cilat do të vazhdojnë të publikohen dhe të jenë të qasshme për zbatuesit e ligjit.

2.4 Zbatimin e trajnimeve për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive

Pjesë e Programit për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2026 janë edhe trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive. Këto trajnime synojnë avancimin e njohurive të kryetarëve, kryeprokurorëve, gjyqtarëve mbikëqyrës të degëve, si dhe udhëheqësve të departamenteve dhe divizioneve, me qëllim përforcimin e aftësive për ushtrimin e përgjegjësiave menaxheriale në gjykata dhe prokurori.

2.5 Zbatimi i trajnimeve të përbashkëta me odat e profesioneve të lira

Si rezultat i marrëveshjeve të bashkëpunimit me odat e profesioneve të lira dhe sipas kërkesave të dokumenteve strategjike, Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulave trajnuese të përbashkëta. Kjo veçanërisht përfshin bashkëpunimin me mbrojtësit e viktimave, ndërmjetësuesit, avokatët shtetërorë, përmbaruesit, zyrtarët e ndihmës juridike falas dhe profesionistë të tjerë ligjorë, të cilëve puna lidhet drejtpërdrejt me funksionimin e gjykatave dhe prokurorive.

2.6 Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë zbatimin e trajnimeve sipas moduleve bazike për bashkëpunëtorët profesionalë dhe zyrtarët ligjorë që nuk i kanë ndjekur më parë këto trajnime. Fokusi kryesor do të jetë përfshirja e të gjithë bashkëpunëtorëve profesionalë dhe zyrtarëve ligjorë në gjykata dhe prokurori, si dhe realizimi i trajnimeve të tjera sipas kërkesave dhe nevojave të identifikuara nga AD. Kjo do të kontribuojë në standardizimin e praktikave të punës dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve mbështetëse në gjykata dhe prokurori. Përmes këtyre trajnimeve synohet gjithashtu fuqizimi i rolit të bashkëpunëtorëve profesionalë në

mbështetje të funksioneve gjyqësore dhe prokuroriale, duke rritur përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin e tyre.

Sipas kërkesave të Strategjisë për Sundimin e Ligjit, bashkëpunëtorët profesionalë dhe zyrtarët ligjorë të Gjykatës Komerciale do të përfitojnë edhe nga trajnimet e dedikuara gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale.

2.7 Zbatimi i trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

Stafi administrativ gjyqësor dhe prokurorial janë faktor kyç në përmirësimin e efikasitetit të punës së gjykatave dhe prokurorive. Marrë parasysh rëndësinë e kësaj kategorie përfituese, Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë zbatimin e trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial me qëllim të avancimit të njohurive profesionale, për rritjen e cilësisë së shërbimeve, efikasitetit të proceseve dhe ndërtimin e një sistemi gjyqësor sa më të besueshëm.

2.8 Zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas vlerësimit të Performancës

Akademia e Drejtësisë do të jetë e gatshme të angazhohet në realizimin e trajnimeve të detyrueshme për gjyqtarë dhe prokurorë, në përputhje me kërkesat e KGJK-së dhe KPK-së. Në rast se paraqiten kërkesa të tilla, Akademia do të bashkëpunojë me të dy këshillat për hartimin e programeve trajnuese, duke u koordinuar me Komisionet për Vlerësimin e Performancës dhe në përputhje me protokollet e përcaktuara për këtë lloj trajnimesh.

2.9 Zbatimi i trajnimit të trajnuesve sipas metodologjisë së përcaktuar në Doracakun për Trajnues

Trajnimi i trajnuesve përbën një komponent kyç në zhvillimin e kapaciteteve profesionale të Akademisë dhe në sigurimin e cilësisë së trajnimeve. Qëllimi i këtyre trajnimeve është krijimi i një baze të qëndrueshme trajnuesish të aftësuar për dizajnimin, zbatimin dhe vlerësimin e trajnimeve efektive në fushat përkatëse.

Gjatë vitit 2025, ky proces ka rezultuar i suksesshëm në ngritjen e aftësive të trajnuesve lidhur me metodologjinë e përcaktuar në Doracakun për Trajnues. Për këtë arsye, edhe gjatë vitit 2026 planifikohet vazhdimi i trajnimeve për trajnues, me qëllim zgjerimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të njohurive mbi metodologjinë trajnuese.

Për vitin 2026, janë planifikuar tre trajnime të trajnuesve, secili me kohëzgjatje prej dy ditësh, që përbën gjithsej gjashtë ditë trajnimi.

2.10 Zbatimi i trajnimeve përmes platformës në distancë

Kurset e mësimi në distancë vazhdojnë të jenë të disponueshme për të gjithë ata që nuk kanë mundësi të marrin pjesë fizikisht në trajnimet e AD-së.

Në kuadër të platformës E-mësimi, gjatë vitit 2026 planifikohet zhvillimi i kurseve trajnues si:

- Etika dhe sjellja profesionale për gjyqtarë

- Etika dhe sjellja profesionale për prokurorë
- Dënimet që shqiptohen ndaj të miturit

Që nga viti 2023, në platformën HELP, e cila është rezultat i bashkëpunimit me Sekretariatën e Këshillit të Evropës, janë të disponueshme 25 kurse, kryesisht në fushat e të drejtave të njeriut, dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, qasjes së grave në drejtësi, si dhe arsytimit dhe shkrimit ligjor. Këto kurse trajnimi do të aktivizohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e përfituesve të AD-së, sipas ligjit.

2.11 Punëtorja për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme 2027

Pas vlerësimit të nevojave trajnuese, Akademia e Drejtësisë do të organizojë Punëtorinë për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2027. Qëllimi i punëtorisë është që bazuar në rezultatet përfundimtare të vlerësimit të nevojave trajnuese, të hartohet drafti i Programit për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2027. Gjatë punëtorisë përcaktohen temat relevante dhe përfundimtare që do të përfshihen në program.

Këshilli Programor dhe trajnuesit e angazhuar sipas vendimit të Këshillit Drejtues, do të hartojnë përmbajtjen e secilës temë në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga AD.

3. Zhvillimi i programeve trajnuese, ngritja e cilësisë së trajnimeve, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese

Zhvillimit të programeve cilësore dhe të nevojshme të trajnimit i paraprin procesi i vlerësimit të nevojave trajnuese me përfituesit. Në këtë kuadër, Akademia e Drejtësisë, në pajtim me Ligjin nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, veçanërisht nenet 1.8 dhe 1.9, ka për mision zhvillimin dhe avancimin profesional të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve të tjerë të përcaktuar me ligj. Ky funksion realizohet përmes hartimit dhe zbatimit të programeve trajnuese të bazuara në nevojat reale të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, si dhe përmes krijimit dhe ofrimit të burimeve juridike të reja që mbështesin zbatimin praktik të legjislacionit në fuqi.

Ngritja dhe avancimi i cilësisë së trajnimeve varet nga përgatitja dhe përvoja e trajnuesve, cilësia e programeve trajnuese, si dhe përdorimi i metodologjive të avancuara në ofrimin e trajnimeve. Analizat dhe hulumtimet përbëjnë një instrument thelbësor për zhvillimin e programeve trajnuese të përshtatura me nevojat reale të përfituesve dhe përmirësimin e cilësisë së tyre. Përveç kësaj, krijimi dhe zhvillimi i botimeve të reja në fushën juridike, duke përfshirë përmbledhjet e praktikës gjyqësore, doracakët, udhëzuesit dhe format e tjera që lehtësojnë punën praktike të gjyqtarëve dhe prokurorëve, mbetet një prioritet kryesor sipas Ligjit për Akademinë e Drejtësisë. Në këtë kontekst, për vitin 2026, Akademia e Drejtësisë do të përqendrohet në aktivitetet hulumtuese, veprimtarinë botuese dhe monitorimin e performancës së trajnuesve, duke i orientuar veprimtaritë në nën-objektivat si më poshtë:

- 3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit të vlerësimit të nevojave trajnuese, si dhe të nevojave për botime ligjore për përfituesit e Akademisë së Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për vitin 2027;
- 3.2 Zhvillimi i procesit për vlerësimin e ndikimit të trajnimeve dhe vlerësimit të performancës së trajnuesve për vitin 2026 si dhe rekrutimi i trajnerëve të rinj;
- 3.3 Zhvillimi i botimeve të reja dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit e trajnimeve pranë Akademisë së Drejtësisë;

- 3.4 Zbatimi i masave dhe politikave eurointegruese, si dhe raportimi i rregullt në mekanizmat përkatës;
- 3.5 Zhvillimi i Strategjisë Institucionale dhe i Planit të Veprimit të Akademisë së Drejtësisë.

Gjatë vitit 2026, Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në vlerësimin e nevojave trajnuese për programet e ardhshme të trajnimit, matjen e ndikimit të trajnimeve, si dhe përgatitjen e të dhënave për vlerësimin e performancës së trajnuesve. Gjithashtu, do të vazhdojë zhvillimin e veprimtarisë botuese në përputhje me prioritetet dhe kërkesat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet promovimit dhe përditësimit të resurseve të bibliotekës, përfshirë informimin e vazhdueshëm të përdoruesve mbi materialet e reja ligjore dhe qasjen në bazën e të dhënave.

3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave trajnuese dhe nevojave për botime ligjore për përfituesit e AD-së sipas ligjit për vitin 2026

Për zhvillimin e programeve cilësore të trajnimeve që adresojnë nevojat reale, si dhe të botimeve juridike që trajtojnë risitë ligjore dhe praktikat e konsoliduara gjyqësore, i paraprinë procese efektive dhe gjithëpërfshirëse të vlerësimit të nevojave, qoftë për trajnime, ashtu edhe për botime dhe publikime.

Procesi i vlerësimit, me theks të veçantë në identifikimin e nevojave trajnuese dhe të zhvillimit të burimeve të reja juridike, përbën dy komponentë me rëndësi për realizimin e suksesshëm të funksionit të Akademisë së Drejtësisë.

Në realizim të këtij funksioni, Akademia do të vazhdojë gjatë gjithë vitit të zbatojë mekanizmat e konsoliduar për mbledhjen sistematike dhe analizën e të dhënave lidhur me programin trajnues dhe planin e botimeve. Angazhimet do të fokusohen kryesisht në analiza dhe hulumtime, mbledhjen e burimeve dhe informatave, si dhe përpunimin e tyre sipas metodologjisë së konsoliduar të AD-së. Përveç mbledhjes dhe monitorimit të strategjive dhe raporteve monitoruese, kombëtare dhe ndërkombëtare, gjithashtu do të realizohen takime dhe punëtori të përbashkëta me gjyqtarë, prokurorë dhe krerët kryesorë të gjykatave dhe prokurorive, për vlerësimin e nevojave trajnuese.

Përmbledhja dhe rezultatet e dala nga këto mekanizma do të shërbejnë si pikënisje për hartimin e programeve nga Këshilli Programor dhe Këshilli Drejtues.

3.2 Zhvillimi i procesit për vlerësimin e ndikimit të trajnimeve dhe vlerësimit të performancës së trajnuesve për vitin 2026 dhe rekrutimi i trajnerëve të rinj

Përvetësimi i njohurive nga trajnimet, si dhe ndikimi i tyre në avancimin e njohurive të pjesëmarrësve, mbetet një ndër nën-objektivat me prioritet i Akademisë së Drejtësisë. Metodologjia e konsoliduar e AD-së, e përshkruar në Doracakun për Trajnues për matjen dhe vlerësimin e ndikimit të trajnimeve, prezanton një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e proceseve të nevojshme për pasqyrimin e efikasitetit të trajnimeve të ofruara nga Akademia.

Në këtë kontekst, për Akademinë e Drejtësisë, procesi i suksesshëm i vlerësimit të ndikimit është thelbësor për zhvillimin e mëtejshëm të programeve trajnuese, pasi veprimtaria e saj synon avancimin e njohurive profesionale të akterëve të sistemit të drejtësisë. Zbatimi i këtij procesi paraqet një sfidë për AD-në, pasi si institucion ajo ka kompetencë ligjore për të ofruar trajnime sipas nevojave, ndërsa performanca e pjesëmarrësve në zbatimin praktik, edhe pse fokusohet përmes trajnimeve, vlerësohet kryesisht nga mekanizmat brenda KGJK-së dhe KPK-së që monitorojnë dhe vlerësojnë performancën e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Sidoqoftë, për të identifikuar në një masë efektin e trajnimeve, Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2026 do të zbatojë pyetësorë para dhe menjëherë pas trajnimit, si një instrument për të matur përvetësimin e njohurive nga pjesëmarrësit. Ky mekanizëm, edhe pse disa pjesëmarrës mund ta anashkalojnë, është relativisht i lehtë për t'u zbatuar, pasi pjesëmarrësit ndodhen fizikisht në sallë dhe nuk ekzistojnë faktorë që e pengojnë plotësimin e pyetësorit.

Akademia do të fokusohet në zbatimin e këtij mekanizmi, duke përfshirë shqyrtimin sistematik të pyetësorëve para dhe pas trajnimit gjatë gjithë vitit 2026. Ky instrument do të mundësojë vlerësimin se si përmbajtja e trajnimit ndikon në njohuritë e pjesëmarrësve dhe, rrjedhimisht, do të matë ndikimin e trajnimeve. Të dhënat e mbledhura dhe analizat nga pyetësorët do të shërbejnë si bazë për përgatitjen e Raportit Analitik për të gjitha trajnimet që do të realizohen gjatë vitit.

Zbatimi i suksesshëm i trajnimeve dhe niveli i përvetësimit të njohurive varen kryesisht nga trajnuesit që i ofrojnë ato, por suksesi i plotë i trajnimit gjithashtu ndikohet nga angazhimi dhe interaktiviteti i pjesëmarrësve. Prandaj, në parim, instrumenti kryesor për zbatimin e trajnimeve cilësore janë trajnuesit dhe përdorimi nga ta i metodologjisë trajnuese të AD-së. Performanca e trajnuesve në realizimin e trajnimeve është shumë e rëndësishme dhe mbetet prioritet për Akademinë e Drejtësisë. Në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore të AD-së, si dhe Doracakun për Trajnues, do të administrohet procesi i zbatueshmërisë së trajnimeve përmes mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave për trajnuesit, duke përfshirë angazhimin e tyre, përgatitjen e materialeve trajnuese dhe zbatimin e trajnimeve në përputhje me objektivat dhe kërkesat përkatëse. Nga monitorimi i zbatueshmërisë së programeve trajnuese do të përgatiten raportet përkatëse për shqyrtimin e performancës së trajnuesve nga Këshilli Programor, dhe më pas edhe nga Këshilli Drejtues.

3.3 Zhvillimi i botimeve të reja dhe ofrimi i këtyre burimeve ligjore për përfituesit e trajnimeve të AD-së

Pjesë e rëndësishme e punës së Akademisë së Drejtësisë mbetet zhvillimi i burimeve të reja juridike që lehtësojnë zbatimin praktik të legjislacionit në fuqi. Në këtë kontekst, do të vazhdojë angazhimi dhe bashkëpunimi me Gjykatën Supreme, KGJK-në, Prokurorinë e Shtetit, KPK-në, gjykatat dhe prokuroritë, për zhvillimin e përmbledhjeve të praktikës gjyqësore, udhëzuesve, komentareve dhe doracakëve, të cilat kanë rezultuar nga vlerësimi i nevojave për botime dhe publikime.

Për vitin 2026, me prioritet janë publikimet që Akademia e Drejtësisë synon t'i hartojë dhe t'i botojë, të cilat janë si në vijim:

1. Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile;
2. Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës;

3. Komentari i drejtësisë për të mitur, me raste nga praktika gjyqësore;
4. Veprat penale kundër integritetit seksual dhe dhunimet ndaj fëmijëve;
5. Përgjegjësia penale e personave juridikë;
6. Praktikën për masat e diversitetit;
7. Ndërmjetësimi në çështje familjare dhe vendimi i gjykatës në raport me marrëveshjen e ndërmjetësimit;
8. Udhëzues për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë;
9. Udhëzues për paraburgimin.

Për hartimin e botimeve përkatëse do të angazhohen autorë nga kuadri ligjor i gjykatave dhe prokurorive, ndërsa përmbajtja e tyre do të zhvillohet duke reflektuar vërejtjet dhe nevojat e identifikuar nga praktika gjyqësore.

Biblioteka elektronike e AD-së, me resurset e saj, do të vazhdojë të jetë në funksion të përfituesve, duke ofruar asistencë për qasjen sipas kërkesave të tyre. Akademia do të vazhdojë anëtarësimin në ABEK, duke siguruar pagesën vjetore një shumë simbolike që mundëson qasje në databaza ndërkombëtare të ndryshme që ky konzorcium ofron për vendet në zhvillim.

3.4 Zbatimi i masave dhe politikave euro-integruese si dhe raportimi i rregullt në mekanizmat përkatës

Edhe gjatë vitit 2026, Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë të përcjellë zhvillimet lidhur me planifikimet strategjike të institucioneve të sistemit të drejtësisë. Ajo do të jetë pjesë aktive e hartimit dhe rishikimit të masave afatmesme në të gjitha planet e veprimit ku përfshihet si institucion. Në këtë kontekst, AD do të shqyrtojë raportet e organizatave vendore dhe ndërkombëtare që monitorojnë sistemin e drejtësisë, duke përfshirë rekomandimet e reja që synojnë rritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe do t'i integrojë ato në planifikimet për programet trajnuese. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet analizës së të gjeturave dhe rekomandimeve nga raporti i Këshillit të Evropës për Kosovën, si dhe bashkëpunimit me autoritetet në ZKM për përgatitjen e inputeve të AD-së për këtë raport. Përveç kontributit në planifikim, AD do të monitorojë zbatueshmërinë e strategjive në nivel kombëtar, duke përgatitur raporte me të dhëna sipas indikatorëve, në baza të rregullta dhe në përputhje me kërkesat e mekanizmave përkatës.

Në këtë drejtim, Akademia e Drejtësisë do të forcojë mekanizmat e brendshëm për koordinim ndërinstitutional dhe përgatitjen e të dhënave të standardizuara për raportim. Gjithashtu, do të intensifikohet komunikimi me partnerët ndërkombëtarë për të siguruar harmonizimin e veprimeve me politikat e BE-së dhe praktikën më të mira evropiane. Këto veprime synojnë rritjen e transparencës dhe avancimin e procesit të integrimit evropian të sektorit të drejtësisë.

3.5 Zhvillimi i strategjisë institucionale dhe planit të veprimit të Akademisë së Drejtësisë

Strategjia institucionale e Akademisë së Drejtësisë skadon në fund të vitit 2026, dhe parashikohet nevoja për iniciimin dhe organizimin e procesit të hartimit të strategjisë së re, me qëllim përcaktimin e orientimeve strategjike afatmesme dhe afatgjata, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe harmonizimin e veprimtarisë së Akademisë me prioritetet e reformës në sektorin e drejtësisë, dokumentet strategjike kombëtare dhe standardet evropiane. Në përputhje

me monitorimin dhe zbatimin e masave të dala nga strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit, Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2026 do të zhvillojë strategjinë institucionale duke u fokusuar në pasqyrimin e zhvillimit institucional në linjë me strategjitë nacionale të vendit. Procesi i hartimit të strategjisë institucionale të AD-së do të bazohet në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave dhe informatave që lidhen me përmbushjen e misionit dhe mandatit të saj. Pjesë e hartimit do të jenë të gjitha organet e Akademisë, duke përfshirë akterët kryesorë të sistemit të drejtësisë në Kosovë, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

4. Avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit me partnerët vendorë, donatorët, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare

Bashkëpunimi ndërinstitutional, si dhe ai me donatorë, institucione dhe organizata ndërkombëtare, mbetet një nga objektivat madhore të Akademisë së Drejtësisë në zhvillimin, organizimin dhe ofrimin e trajnimeve. Në këtë drejtim, avancimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit është thelbësor për përmbushjen e misionit dhe vizionit të AD-së. Prandaj, në vitet në vijim, AD do të përqendrohet në dy nën-objektiva, si më poshtë:

- 4.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), si dhe me gjykatat dhe prokuroritë e Kosovës;
- 4.2 Bashkëpunimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë, si dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët, institucionet dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, me qëllim forcimin e sundimit të ligjit.

4.1 Bashkëpunimi dhe koordinimi me KGJK dhe KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës

Në funksion të zbatimit sa më efektiv të programeve trajnuese, Akademia e Drejtësisë do të bashkëpunojë ngushtë me KGJK-në dhe KPK-në, veçanërisht për aktivitetet e mbetura që dalin nga Strategjia për Sundimin e Ligjit, si dhe për trajnime shtesë që mund të nevojiten si rezultat i vlerësimit të performancës.

Koordinimi me kryetarët e gjykatave dhe kryeprokurorët e prokurorive do të vazhdojë për organizimin e trajnimeve sipas aplikimeve, ndërsa bashkëpunimi me administratorët do të fokusohet në zbatimin e trajnimeve bazike për bashkëpunëtorët profesionalë, zyrtarët ligjorë dhe trajnimet e përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë. Gjithashtu, ky bashkëpunim do të përqendrohet në zhvillimin e kurrikulave trajnuese sipas nevojave dhe kërkesave të institucioneve përkatëse, si dhe në shkëmbimin e informatave dhe çështjeve të tjera me interes të përbashkët.

4.2 Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe zgjerimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë, donatorët, institucionet dhe organizatat tjera ndërkombëtare

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë, përmes përfaqësimit të saj në grupet punuese në fushën e legjislacionit dhe politikave për sundimin e

ligjit, si dhe në përgatitjen e inputeve për zbatueshmërinë e strategjive dhe aktivitete të tjera me interes të përbashkët. Vëmendje të veçantë do t'i kushtohet edhe institucioneve dhe organizatave të tjera të sistemit të drejtësisë, me të cilat AD ka arritur marrëveshje bashkëpunimi, dhe të cilat do të ftohen të përfshihen në programin trajnues, varësisht nga çështjet e interesit dhe fushëveprimet e tyre.

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë përkushtimin e saj në projekte të përbashkëta ndërkombëtare edhe gjatë vitit 2026. Në funksion të kësaj, ajo do të jetë pjesë e nismave të ndryshme rajonale dhe më gjerë, veçanërisht në fusha që kanë si mision kryesor zhvillimin e praktikave më të mira për avancimin dhe forcimin e përpjekjeve për një sistem efikas të drejtësisë. Akademia do t'i mundësojë trajnuesve, dhe veçanërisht përfituesve të saj, pjesëmarrjen në trajnime, forume, konferenca dhe punëtori të ndryshme në institucione trajnimi gjyqësor në nivel rajonal, si dhe në organizata të tjera që fokusohen në avancimin e trajnimit gjyqësor dhe promovimin e sundimit të ligjit.

Gjatë vitit 2026, Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë bashkëpunimin me organizatat dhe institucionet me të cilat ka ndërtuar një traditë dhe stabilitet në realizimin e objektivave të programeve trajnuese. Përkundër që disa nga projektet ndërkombëtare janë përfunduar ose pezulluar, siç është rasti me projektet e mbështetura nga USAID, OPDAT etj., Akademia e Drejtësisë mbetet e përkushtuar dhe e gatshme të rifillojë bashkëpunimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta sapo këto projekte të riaktivizohen.

Në këtë drejtim, Akademia e Drejtësisë synon të mbajë dhe forcojë partneritetin me projektet e Këshillit të Evropës, OSBE-së, EULEX-it, projektet e Bashkimit Evropian, EJTN, INL, ERA, EIPA, UNDP, GIZ dhe UNODC. Prioritet, edhe gjatë vitit 2026, do të jetë mundësia e pjesëmarrjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve në programet trajnuese të EJTN dhe ERA, si dhe në programet për shkëmbim në institucionet trajnuese rajonale.

5. Ngritja e kapaciteteve profesionale administrative, cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit

Ngritja e kapaciteteve profesionale administrative, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve administrative dhe menaxhimi efektiv i shpenzimeve financiare mbeten prioritet kryesor që do ta udhëheqin Akademinë e Drejtësisë edhe gjatë vitit 2026. Struktura e brendshme organizative e Akademisë, e ndarë në dy departamente dhe tetë divizione, siguron me kompetencat e saj zbatimin efikas të Planit të Punës dhe Performancës.

Përmbushja e detyrave me kompetencë, profesionalizëm dhe efektivitet kërkon njohuri të duhura profesionale, ngritje të vazhdueshme të kapaciteteve dhe përmirësim të infrastrukturës fizike, në drejtim të ofrimit të kushteve më të mira për punë, me qëllim mundësimin e një pune më efikase. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2026, Akademia e Drejtësisë do t'i përkushtohet veçanërisht funksionalizimit të objektit të ri të AD-së, meqë punimet ndërtimore pritet të përfundojnë në gjysmën e dytë të vitit 2026.

Sistemimi i personelit, inventarit, dokumentacionit, mallrave dhe shërbimeve në objektin e ri kërkon planifikim të kujdesshëm dhe mobilizim të gjithë strukturës së brendshme organizative. Për këtë arsye, do të vazhdohet komunikimi i rregullt me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), përkatësisht me Departamentin për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe Menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ), si dhe, në kohën e duhur, Akademia e Drejtësisë do të përgatisë planet e mobilizimit dhe planin e zhvendosjes në objektin e ri.

Funksionimi efikas i proceseve të punës dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve realizohen përmes ndarjes së qartë të përgjegjësiave, ndërveprimit dhe mbikëqyrjes së departamenteve dhe njësive të tjera organizative. Në këtë kuadër, në Planin e Punës dhe Performancës për vitin 2026, përqendrimi i AD-së do të jetë në nën-objektivat si më poshtë:

- 5.1 Ngritja e cilësisë së shërbimeve ligjore dhe mbështetja e organeve të Akademisë së Drejtësisë;
- 5.2 Ngritja e Komunikimit Institucional dhe Marrëdhënieve me Publikun;
- 5.3 Avancimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI), mirëmbajtja dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve;
- 5.4 Avancimi i kapaciteteve profesionale administrative, përmirësimi i proceseve të personelit dhe rritja e efikasitetit në proceset e punës;
- 5.5 Ngritja e cilësisë së shërbimeve të mbështetjes administrative dhe logjistike, si dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike;
- 5.6 Ngritja e cilësisë së furnizimeve me mallra dhe shërbime, si dhe menaxhimi efektiv i kontratave;
- 5.7 Menaxhimi dhe zbatimi efikas i resurseve financiare.

5.1 Ngritja e cilësisë së shërbimeve ligjore dhe mbështetja e organeve të Akademisë së Drejtësisë

Akademia e Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet nënligjore përkatëse, synon të sigurojë mbështetje të qëndrueshme dhe profesionale ligjore për organet drejtuese dhe njësitë e saj përbërëse. Përmes këtij angazhimi sigurohet së vendimet e marra nga organet e Akademisë të bazohen në interpretim korrekt të ligjeve dhe akteve nënligjore, duke rritur cilësinë, saktësinë dhe efektivitetin e vendimmarrjes institucionale.

Gjithashtu, nisma e filluar për hartimin e akteve nënligjore në vitin 2025 do të vazhdojë edhe gjatë pjesës së parë të vitit 2026. Puna e komisioneve do të përqendrohet në hartimin e akteve nënligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke u fokusuar në rregullimin e marrëdhënieve të punës për nëpunësit civilë me status të veçantë.

Në këtë drejtim do të realizohet:

- Mbështetje ligjore në nxjerrjen e vendimeve nga organet e Akademisë së Drejtësisë, duke siguruar vendimmarrje të bazuar në ligj dhe në rregulloret në fuqi;
- Hartimi, shqyrtimi dhe përmirësimi i akteve nënligjore të Akademisë, duke përfshirë rregulloret ekzistuese dhe projekt-rregulloret e reja, të parashikuara me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Zyrtarët Publikë, të cilat rregullojnë marrëdhënien e punës për nëpunësit civilë me status të veçantë. Po ashtu, vazhdimi i procesit të hartimit të projekt-rregullores për trajnerë dhe mentorë, si dhe të projekt-rregullores për tarifat e trajnimeve për profesionet e lira;
- Mbikëqyrja dhe monitorimi i ndryshimeve legjislative, interpretimi i dispozitave ligjore dhe i akteve të tjera nënligjore relevante, zhvillimi dhe monitorimi i Planit të Integritetit Institucional, si dhe informimi i njësive dhe organeve të Akademisë për ndikimin e tyre në proceset dhe funksionet institucionale;

- Sigurimi i përkthimeve dhe përshtatja e dokumenteve, botimeve dhe vendimeve, në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare, për të garantuar qasje të barabartë dhe të drejtë për të gjitha palët dhe për publikun;
- Përforsimi i kapaciteteve institucionale për analizë ligjore, përfshirë komunikimin me Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP), rishikimin dhe monitorimin e kontratave për mallra dhe shërbime, parashtrimin e mjeteve juridike dhe përfaqësimin e Akademisë në gjykata, me qëllim rritjen e cilësisë së vendimmarrjes dhe mbështetjes ligjore të planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të Akademisë.

Ky nën-objektiv synon të forcojë integritetin, transparencën dhe profesionalizmin e shërbimeve ligjore dhe të përgjithshme të Akademisë, duke mbështetur vendimmarrjen e organeve drejtuese dhe duke siguruar që të gjitha proceset të jenë të qasshme, të dokumentuara dhe të harmonizuara me legjislacionin dhe aktet nënligjore përkatëse.

5.2 Ngritja e Komunikimit Institucional dhe Marrëdhënieve me Publikun

Akademia e Drejtësisë, në përputhje me parimin e administratës së hapur dhe detyrimet ligjore për transparencë dhe qasje në dokumentet publike, do të vazhdojë të publikojë rregullisht të gjitha informacionet dhe dokumentet e rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e saj institucionale. Këto përfshijnë Planet e Punës dhe të Performancës, raportet tremujore dhe vjetore, rezultatet e monitorimit, si dhe vendimet e Këshillit Drejtues, si organi më i lartë vendimmarrës i Akademisë. Dokumentet do të jenë të qasshme për publikun përmes webfaqes zyrtare dhe kanaleve të tjera të komunikimit institucional.

Në funksion të forcimit të marrëdhënieve me publikun, Akademia do të zgjerojë bashkëpunimin me shoqërinë civile, partnerët ndërkombëtarë, OJQ-të relevante dhe institucionet e sistemit të drejtësisë, me qëllim integrimin e perspektivave të tyre në procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese dhe hartimin e programeve të reja. Në këtë kuadër, do të organizohen takime konsultative, diskutime publike dhe forma të tjera të shkëmbimit të informacionit për të avancuar politikat dhe praktikat trajnuese.

Gjithashtu, Akademia do të sigurojë përditësimin e vazhdueshëm të webfaqes zyrtare dhe profileve në rrjetet sociale me informacione të sakta, të plota dhe të kohës, që lidhen me punën e organeve drejtuese, aktivitetet trajnuese, njoftimet publike, shpalljet dhe veprimtaritë e tjera institucionale. Transparenca do të rritet përmes publikimit të të dhënave mbi aktivitetet, bashkëpunimet dhe rezultatet e arritura, duke mundësuar qasje të barabartë për të gjitha palët e interesit. Në kuadër të këtij nën-objektivi, Akademia do të zhvillojë dhe realizojë aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe komunikimit publik, duke organizuar veprimtari specifike si pjesë aktive e fushatës ndërkombëtare “16 Ditët e Aktivizmit” kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave. Si pjesë e kësaj fushate, AD do të promovojë qasje të unifikuar, të ndjeshme gjinore dhe mbrojtëse ndaj viktimave, si dhe do të forcojë bashkëpunimin dhe koordinimin ndërinstitutional.

Në tërësi, ky objektiv synon forcimin e besueshmërisë publike, thellimin e komunikimit institucional dhe krijimin e një mjedisi të hapur, ku publiku, partnerët dhe profesionistët e drejtësisë kanë qasje të plotë, transparente dhe të vazhdueshme në informacionet më të rëndësishme mbi punën dhe misionin e Akademisë së Drejtësisë.

5.3 Avancimi i sistemeve të TI-së, mirëmbajtja dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve

Gjatë vitit 2026, Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë avancimin dhe mbështetjen e funksionimit të përgjithshëm të sistemeve të TI-së, të cilat përdoren për realizimin e proceseve trajnuese, administrative dhe organizative. Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e aktiviteteve të AD-së realizohet përmes platformave digjitale, zhvillimi, avancimi dhe mirëmbajtja e tyre mbeten aktivitete kryesore, me qëllim garantimin e një infrastrukture të qëndrueshme, të sigurt dhe efikase të TI-së.

Në këtë kuadër, aktivitetet në fushën e TI-së do të fokusohet si më poshtë:

- Avancimi i përdorimit të platformës së mësimi në distancë, duke përfshirë mirëmbajtjen teknike, rritjen e stabilitetit, përditësimin e funksionaliteteve dhe mbështetjen e stafit dhe trajnerëve në përdorimin e saj;
- Administrimi dhe zhvillimi i sistemit elektronik të menaxhimit të aktiviteteve trajnuese, duke përmirësuar regjistrimet online, komunikimin elektronik, menaxhimin e orareve dhe raportimin automatik;
- Zhvillimi dhe avancimi i modulit të testimit online dhe aplikimeve digjitale për pjesëmarrësit në trajnim, me qëllim rritjen e efikasitetit dhe transparencës së proceseve;
- Mirëmbajtja e harduerit dhe softuerit, përfshirë serverët, kompjuterët, pajisjet e rrjetit, pajisjet e sallave të trajnimit dhe softuerët e licencuar;
- Rritja e kapaciteteve për sigurinë kibernetike, përmes zbatimit të masave të brendshme të kontrollit të qasjes, mirëmbajtjes së kopjeve rezervë dhe koordinimit të vazhdueshëm me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, për mbrojtje nga ndërhyrjet dhe menaxhim të reziqeve kibernetike;
- Automatizimi i proceseve të TI-së, përfshirë integrimin e funksioneve digjitale që reduktojnë punën manuale dhe përmirësojnë cilësinë e të dhënave;
- Shkëmbimi dhe ndërlidhja e informacionit me KGJK-në dhe KPK-në, në përputhje me standardet e interoperabilitetit dhe sigurisë institucionale;
- Mbështetje teknike e drejtpërdrejtë për të gjitha departamentet dhe divizionet, në proceset e tyre të përditshme të punës dhe në realizimin e aktiviteteve të planifikuara.

Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, Akademia e Drejtësisë synon të avancojë dhe modernizojë shërbimet e TI-së, të përshpejtojë transformimin digjital dhe të sigurojë një ambient teknologjik të qëndrueshëm dhe funksional për të gjitha programet dhe shërbimet e institucionit.

5.4 Avancimi i kapaciteteve profesionale administrative, proceseve të personelit, dhe rritja e efikasitetit në proceset e punës

Gjatë vitit 2025, Akademia e Drejtësisë ka funksionalizuar plotësisht strukturën e brendshme organizative, e përcaktuar me Rregulloren nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës. Kjo strukturë, që përfshin dy departamente dhe tetë divizione, ka gjithsej 36 pozita të planifikuara, nga të cilat 32 janë aktualisht të lejuara sipas Ligjit për Buxhetin. Pritet që katër(4) pozitat e mbetura të përfshihen në ndarjet buxhetore të vitit 2026, duke mundur plotësimin e kapaciteteve të nevojshme për ushtrimin e funksioneve ligjore të institucionit.

Në funksion të konsolidimit të strukturës organizative, Akademia e Drejtësisë ka siguruar zhvillimin e procedurave të rekrutimit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e

institucionit, duke garantuar transparencë, konkurrencë të drejtë dhe dokumentim të plotë të çdo faze të procesit. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar gjithsej tre procedura rekrutimi, të cilat kanë rezultuar të suksesshme me përzgjedhjen e kandidatëve fitues, si dhe një procedurë transferi të përhershëm në interes të institucionit. Në vazhdim të këtij procesi, për vitin 2026 është hartuar planifikimi i rekrutimit, i cili parasheh realizimin e procedurave për tre(3) pozitat aktualisht të lira në AD, katër(4) pozitat shtesë të miratuara me Rregulloren nr. 05/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, që pritet të lejohen me Ligjin për Buxhetin e vitit 2026, si dhe zhvillimin e procedurave për zëvendësimin e pozicioneve të liruara ose të riorganizuara gjatë vitit 2026.

Fokus i veçantë gjatë vitit të ardhshëm do të jetë forcimi i kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve të vazhdueshme të brendshme dhe të jashtme, ndërsa bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim të stafit, fushat me prioritet të aftësimit do të përfshijnë:

- Legjislacionin e administratës publike dhe zbatimin e tij praktik
- Udhëheqja dhe menaxhimi, hartimi i planeve dhe raporteve të institucionit
- Menaxhimin e kontratave dhe monitorimin e tyre
- Përmirësimin e kompetencave profesionale dhe teknike sipas profileve të pozitive
- Ngritja e aftësive administrative, komunikimit institucional dhe qasjes në shërbime cilësore
- Teknologjitë e informacionit dhe përdorimin efikas të sistemeve elektronike.

Në përputhje me dispozitat e legjislacionit për zyrtarët publik dhe akteve nënligjore të brendshme të AD-së, synohet që proceset e punës të jenë gjithnjë e më të standardizuara, transparente dhe të orientuara drejt performancës. Rritja e efikasitetit të punës do të mbështetet përmes:

- Shpërndarjes së qartë të përgjegjësiave brenda njësive organizative
- Zbatimit të standardeve të brendshme për menaxhimin e proceseve
- Ngritjes së cilësisë së raportimeve dhe monitorimit të punës
- Përmirësimit të koordinimit ndër departamente dhe divizione
- Rritjes së përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e detyrave.

Në këtë mënyrë, për vitin 2026, Akademia e Drejtësisë synon jo vetëm të konsolidojë strukturën e saj organizative, por edhe të avancojë në mënyrë të qëndrueshme cilësinë e shërbimeve, profesionalizmin e stafit dhe efikasitetin e përgjithshëm institucional.

5.5 Ngritja e cilësisë së shërbimeve të mbështetjes administrative, logjistike, dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike

Departamenti për Shërbime Ligjore dhe të Përgjithshme, përmes Divizionit për Mbështetje Administrative dhe Logjistike, do të vazhdojë të ofrojë mbështetje të plotë administrative, logjistike dhe operacionale në zbatimin e Planit Vjetor të Punës së Akademisë së Drejtësisë. Duke pasur parasysh se shërbimet administrative dhe logjistike përbëjnë themelin e funksionimit të përditshëm të Akademisë, gjatë vitit 2026 synohet përmirësimi i mëtejshëm i cilësisë së tyre, standardizimi i procedurave dhe forcimi i efikasitetit operacional.

Në këtë drejtim, prioritetet kryesore do të jenë:

- Hartimi i planit për funksionalizimin e ndërtesës së re të AD-së dhe hartimi i planit të mobilizimit për zhvendosjen në objektin e ri;

- Planifikimi dhe koordinimi i zhvendosjes dhe funksionalizimit të ndërtesës së re, duke siguruar që shërbimet administrative, logjistike dhe infrastrukturore të jenë të gatshme dhe të standardizuara për fillimin e punës në objektin e ri;
- Organizimi dhe realizimi i inaugurimit të ndërtesës së re të Akademisë së Drejtësisë, në koordinim me institucionet relevante, me ftesë për institucionet e sistemit të drejtësisë së vendit, institucionet trajnuese të Bashkimit Evropian, të vendeve të rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe të Turqisë, në përputhje me protokollet zyrtare;
- Menaxhimi dhe administrimi i dokumenteve institucionale, përfshirë standardizimin e formularëve, arkivimin sipas rregullave, digjitalizimin gradual të dokumenteve dhe përmirësimin e qasjes së brendshme në dokumentacion;
- Mirëmbajtja e sallave të trajnimeve dhe ambienteve të punës, duke siguruar pajisje adekuate të TI-së, kushte të përshtatshme logjistike dhe përkrahje operative gjatë realizimit të trajnimeve;
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e inventarit dhe infrastrukturës, përfshirë kontrollin e rregullt të gjendjes, regjistrimin elektronik të pajisjeve, mirëmbajtjen parandaluese dhe menaxhimin e aseteve të reja;
- Organizimi dhe ofrimi i shërbimeve të transportit, sipas aktiviteteve trajnuese dhe nevojave zyrtare, duke siguruar menaxhim të rregullt dhe efikas të automjeteve;
- Mbështetje e drejtpërdrejtë për aktivitetet trajnuese, botuese dhe kërkimore, në aspektin logjistik, administrativ dhe organizativ;
- Zbatimi i procedurave të brendshme administrative, përfshirë kontrollin e punëve të përgjithshme, bashkërendimin ndërdepartamental dhe raportimin e rregullt operacional;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimit ndaj stafit dhe palëve të jashtme, duke rritur profesionalizmin, koordinimin dhe përgjegjshmërinë në ushtrimin e detyrave.

Duke u mbështetur në parimet e efikasitetit, transparencës dhe profesionalizmit, ky nën-objektiv ka për qëllim që shërbimet administrative dhe logjistike të jenë plotësisht funksionale, të standardizuara dhe të ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për mbarëvajtjen e të gjitha proceseve institucionale.

5.6 Ngritja e cilësisë së furnizimeve me mallra dhe shërbime dhe menaxhimi efektiv i kontratave

Megjithëse buxheti është i pamjaftueshëm, një pjesë e konsiderueshme e tij planifikohet të shpenzohet për mallra dhe shërbime. Të gjitha furnizimet me mallra dhe shërbime realizohen përmes kontratave të nënshkruara nga AQP për nevojat e Akademisë së Drejtësisë dhe zbatohen nga OE që zgjidhen përmes procedurave të prokurimit të zhvilluara nga AQP. Andaj, bazuar në kornizën ligjore në fuqi për prokurimin publik në Kosovë, aktivitetet e prokurimit dhe lidhja e kontratave për Akademinë e Drejtësisë janë nën autoritetin e AQP-së. Sipas Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjet Nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-092, Neni 21A), institucionet me më pak se 50 staf të punësuar procedurat e prokurimit i kryen AQP. Sidoqoftë, Akademia e Drejtësisë angazhohet në përgatitjen e planifikimit preliminar dhe përfundimtar të prokurimeve, si dhe në hartimin e specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime sipas nevojave të saj. Përveç përgatitjes së specifikimeve teknike, AD është përgjegjëse për menaxhimin e kontratave pas nënshkrimit të tyre nga AQP, për caktimin e menaxherëve të kontratave, si dhe për përgatitjen dhe zbatimin e planeve të menaxhimit të kontratave në harmoni me legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2026, Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë zbatimin e kontratave për furnizime me mallra dhe shërbime që janë ende në shfrytëzim. Këto përfshijnë furnizime me naftë për automjetet, ngrohje dhe gjeneratorë, materiale të ndryshme për zyrat, pije për kafeterinë, si dhe ushqim të gatshëm dhe pije për pjesëmarrësit në trajnime. Përveç kësaj, do të zbatohen kontratat për furnizime me inventar, shërbime të telefonisë fikse dhe mobile, fotokopjimit dhe printimit, servisimin e automjeteve, pastrimin e objektit dhe sigurimin fizik të tij, duke arritur deri në 20 kontrata gjithsej. Vlerësimi i nevojave për mallra dhe kostos së përgjithshme për këto shërbime pritet të arrijë vlerën prej 250,000 eurove, duke mos llogaritur investimet kapitale, respektivisht funksionalizimin e objektit të ri të AD-së.

5.7 Menaxhimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i resurseve financiare

Buxheti i Republikës së Kosovës përbën burimin kryesor financiar të Akademisë së Drejtësisë. Pjesë shtesë e financimit janë donacionet e ndryshme dhe mbështetja nga partnerët ndërkombëtarë, të cilët kontribuojnë në realizimin e aktiviteteve të Akademisë dhe në përmbushjen e mandatit të saj ligjor.

Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në përgatitjen e kërkesave buxhetore duke vlerësuar nevojën dhe kostot për të gjitha aktivitetet trajnuese, për mallra dhe shërbime, numrin e trajnuesve të angazhuar për zbatimin e trajnimeve, qoftë fillestare apo të vazhdueshme, numrin e përfituesve, si dhe aktivitetet e tjera sipas ligjit të AD-së. Në këtë drejtim, do të zhvillohet një mekanizëm për evidentimin e shpenzimeve sipas programeve trajnuese, angazhimit të trajnuesve, shpenzimeve në fushën e botimeve dhe publikimeve, shërbimeve të mirëmbajtjes dhe shërbimeve të tjera të përgjithshme. Në ndryshim nga vitet e kaluara, nga viti 2026 raporti financiar i AD-së do të adresohet për aprovim në një takim të veçantë të Këshillit Drejtues.

Për vitin 2026, në qarkoren buxhetore është parashikuar një buxhet total prej 880,004.00 euro, përkundër kërkesës buxhetore të AD-së, e cila ka qenë 2,128,160.00 euro, duke përfshirë edhe kërkesën për investime kapitale, përkatësisht pjesën për inventar, pajisje, mallra dhe shërbime të tjera të nevojshme për funksionalizimin e duhur të ndërtesës. Realizimi i aktiviteteve trajnuese të planifikuara në kuadër të PTF-së dhe PTV-së me buxhetin e aprovuar do të jetë shumë i vështirë pa mbështetjen e partnerëve dhe donacionet e tyre.

Akademia e Drejtësisë, konform me mandatin e saj ligjor, është e obliguar të përmbushë kërkesat e KGJK-së dhe KPK-së, gjykatave, prokurorive, si dhe të gjitha aktivitetet tjera trajnuese që rrjedhin nga strategjitë dhe prioritetet që lidhen me procesin euro-integruar të Kosovës. Përgatitja dhe avancimi i aftësimit profesional të gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre përkatëse, mbetet një prioritet i lartë.

Të dy Këshillat kanë zhvilluar procese të reja rekrutimi për gjyqtarë dhe prokurorë të rinj, të cilët pritet të ndjekin trajnimet fillestare që, sipas ligjit, janë të obligueshme. Për këtë arsye, mjetet buxhetore duhet të orientohen kryesisht drejt këtij programi, i cili parashikohet të konsumojë shumën më të madhe të buxhetit, respektivisht 289,681.00 euro vetëm për mallra dhe shërbime.

Në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, zhvillohen një sërë aktivitetesh që janë të obligueshme sipas dokumenteve strategjike për gjyqësorin dhe mekanizmave tjerë integruar. Përveç trajnimeve për gjyqtarë dhe prokurorë, këto aktivitete kërkojnë edhe rritjen e kapaciteteve profesionale të bashkëpunëtorëve profesionalë dhe stafit mbështetës në gjykata

dhe prokurori, duke përfshirë edhe profesionistët e lirë. Kërkesat dhe aktivitetet e parashikuara sipas programeve trajnuese do të ndikojnë në rritjen e shpenzimeve për mallra dhe shërbime, përfshirë përkthimin simultan, përkthimin e moduleve të trajnimit dhe dokumenteve të tjera, shërbimet e pastrimit, ngrohjes dhe furnizimeve të tjera. Një pjesë e konsiderueshme e trajnimeve të vazhdueshme planifikohet të realizohet përmes bashkëpunimit dhe mbështetjes së projekteve dhe organizatave ndërkombëtare. Për vitin 2026, planifikohet që realizimi i buxhetit të ekzekutohet në përqindjen maksimale.

Planifikimit buxhetor do t'i paraprijë vlerësimi i nevojave përmes takimeve dhe vlerësimet brenda departamenteve, divizioneve dhe, sipas nevojës, organeve të Akademisë së Drejtësisë, të cilat luajnë një rol kyç në këtë proces. Planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit do të realizohen duke respektuar rregullat ligjore në fuqi, të cilat sigurojnë zbatimin e planit dhe programeve të Akademisë.

6. Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së AD-së

Në Planin e Veprimit si me poshtë, janë paraqitur objektivat e përgjithshme, të cilat janë në përputhje me nevojat reale të identifikuara në Planin e Punës dhe të Performancës. Objektivat janë të realizueshme dhe të bazuara në kapacitetet ekzistuese, ndërsa një pjesë e madhe e aktiviteteve do të zhvillohen në bashkëpunim me partnerët mbështetës, sipas konfirmimeve të tyre. Mbështetja dhe bashkëpunimi i Akademisë së Drejtësisë me akterët e përfshirë do të përqendrohet në ofrimin e ekspertizës së nevojshme, si dhe mbështetjes financiare dhe logjistike.

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objekti i përgjithshëm	Nën-objekti	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
1. Përgatitja profesionale e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar dhe ngritja e kapaciteteve trajnuese	1. Zbatimi i trajnimit praktik për 21 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së XIII-të në gjykata, nën mbikëqyrjen e mentorit gjyqtar;	Departamenti i Programit të Trajnimit / Divizioni për Trajnime Fillestare	Janar – Maj	10,500.00 €	BKK	Raporti përfundimtar i hartuar për 21 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së XIII-të, të trajnuar në modulet sipas Programit Trajnues 2025–2026;
	2. Zbatimi i trajnimit fillestar për 24 prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së XI-të;	Departamenti i Programit të Trajnimit / Divizioni për Trajnime Fillestare	Janar – Shkurt	12,512.00 €		Raporti përfundimtar i hartuar për 24 prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së XI-të, të trajnuar në modulet sipas Programit Trajnues 2025–2026;
	3. Zbatimi i trajnimit fillestar, duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik, për 20 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së XIV-të;	Departamenti i Programit të Trajnimit / Divizioni për Trajnime Fillestare	Janar - Dhjetor	68,790.00 €		Raporti përfundimtar i hartuar për 20 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së XIV-të, të trajnuar në modulet sipas Programit Trajnues 2025–2026.
	4. Zbatimi i trajnimit fillestar, duke përfshirë trajnimin teorik dhe praktik, për 20 prokurorët të sapoemëruar të gjeneratës së XII-të;	Departamenti i Programit të Trajnimit / Divizioni për Trajnime Fillestare	Qershor -Dhjetor	64,004.00 €		20 prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së XII-të, të trajnuar në modulet përkatëse sipas Programit Trajnues;
	5. Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimit fillestar për 20 gjyqtarët e sapoemëruar të gjeneratës së XV-të dhe për 8 gjyqtarë të komunitetit serb;	Departamenti i Programit të Trajnimit / Divizioni për Trajnime Fillestare	Prill - Dhjetor	43,032.00 € (gjyqtarë)		20 gjyqtarë të sapoemëruar, gjenerata e XV-të 8 gjyqtarë të komunitetit serb
	Totali			198,838.00 €		
	1. Trajnimet nga lëmia Penale	Departamenti i		21,522.00 €		29 trajnime, me pjesëmarrje rreth 725 pjesëmarrës:

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objektivi i përgjithshëm	Nën-objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
2. Avancimi i vazhdueshëm i njohurive profesionale dhe interdisiplinare të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial, si dhe profesionistëve të tjerë ligjorë		Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor			380 nga radhët e gjyqtarëve 220 nga radhët e prokurorëve 85 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë 40 të tjerë (Policia e Kosovës, IPK, Mbrojtës të Viktimave etj.)
	2. Trajnimet nga lëmia Civile	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	6,556.00 €		9 trajnime, me pjesëmarrje rreth 225 pjesëmarrës: 175 nga radhët e gjyqtarëve rreth 50 bashkëpunëtorë profesionalë
	3. Trajnimet nga lëmia e drejtësisë për fëmijë	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	3,576.00 €		5 trajnime, me pjesëmarrje rreth 150 pjesëmarrës: 60 nga radhët e gjyqtarëve 40 nga radhët e prokurorëve 50 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë, zyrtarëve sprovues dhe zyrtarëve policorë
	4. Trajnimet për mbrojtjen nga dhuna në familje	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	2,100.00 €		4 trajnime, me pjesëmarrje rreth 100 pjesëmarrës: 50 nga radhët e gjyqtarëve 25 nga radhët e prokurorëve 25 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë, mbrojtësve të viktimave dhe zyrtarëve të tjerë ligjorë
	5. Trajnimet kundër diskriminimit	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	596,00 €		1 trajnim me pjesëmarrje rreth 20 persona: 11 nga radhët e gjyqtarëve 9 nga radhët e prokurorëve
	6. Trajnimet nga lëmia Komeriale	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	6,952.00 €		10 trajnime me pjesëmarrje rreth 240 persona: 140 nga radhët e gjyqtarëve 100 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë dhe këshilltarëve profesionalë
	7. Trajnimet nga drejtësia kushtetuese, administrative kundërvajtëse	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të	Shkurt - Dhjetor	6,2642.00 €		12 trajnime me pjesëmarrje rreth 120 pjesëmarrës: Prej tyre 90 nga radhët e gjyqtarëve. 30 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë.

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objektivi i përgjithshëm	Nën-objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
		vazhdueshme				
	8. Trajnimet për KEDNJ	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	2,088.00 €		5 trajnime me pjesëmarrje rreth 115 pjesëmarrës. Prej tyre: 60 nga radhët e gjyqtarëve, 30 nga radhët e prokurorëve dhe 25 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë dhe avokatëve shtetërorë.
	9. Trajnimet nga e Drejta e BE-së	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	1,192.00 €		2 trajnime me pjesëmarrje rreth 40 pjesëmarrës. Prej tyre: 20 nga radhët e gjyqtarëve, 15 nga radhët e prokurorëve dhe 5 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë.
	10. Trajnimet nga kompetenca interdisiplinare	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	1,938.00 €		4 trajnime me pjesëmarrje rreth 100. Prej tyre: 70 nga radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe 30 nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë
	11. Trajnimet për menaxhimin e gjykatave dhe prokurorive	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	1,192.00 €		2 trajnime me pjesëmarrje rreth 40. Prej tyre: 20 nga gjykatat dhe 20 nga prokuroritë.
	12. Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve të detyrueshme sipas vlerësimit të performances	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime Fillestare	Janar - Dhjetor	3,035.00 €		Gjyqtarë dhe prokurorë të trajnuar në modulet sipas indikatorëve të performancës
	13. Zbatimi i trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	39,750 €		Rreth 75 trajnime për Modulet Bazike, Civile dhe Penale (15 Grupe, prej tyre 10 grupe për Penale, 5 për civile Përfutuese: 600, bashkëpunëtorëve profesional dhe zyrtarëve ligjor të gjykatave dhe prokurorive Kohëzgjatja: 5 ditë trajnim për një grup (varësisht nga lëmia), Pjesëmarrës: 40 për një grup 1 trajnim për Drejtësinë tranzicionale me rreth 30 pjesëmarrës.

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objektivi i përgjithshëm	Nën-objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
	14. Trajnimet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	15,120.00 €		34 trajnime me rreth 700 pjesëmarrës nga radhët e administratorëve, referentëve, sekretareve juridike, zyrtarëve për menaxhimin e lëndëve të gjykatave dhe prokurorive.
	15. Ofrimi dhe zbatimi i trajnimeve sipas kërkesave të institucioneve të profesioneve të lira	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shkurt - Dhjetor	700 €		Përmbaues privat, mbrojtës të viktimave, zyrtarë të ANJF si dhe zyrtarë të OJQ-ve që ofrojnë ndihmë juridike falas të trajnuar në trajnime të përbashkëta me gjyqtarë dhe prokurorë si dhe trajnime të për profesionet e lira.
	16. Zbatimi i trajnimeve për trajnues	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime Fillestare	Janar - Dhjetor	10,272 €		60 trajnues të trajnuar (trajnime të trajnuesve me mbështetëj të AD-së apo në bashkëpunim me donatorë).
	17. Zbatimi i kurseve online E-mësimi	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizionet për trajnime të vazhdueshme / Divizioni i TI-së	Shkurt - Dhjetor	1,200 €		Në kuadër të platformës E-mësimi, gjatë vitit 2026 synohet të zhvillohen kurset trajnues si: - Etika dhe sjellja profesionale për gjyqtarë - Etika dhe sjellja profesionale për prokurorë Dënimet që shqiptohen ndaj të miturit
	18. Punësoria për Hartimin e Programit për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2027	Departamenti i Programeve të Trajnimit / Divizioni për trajnime të vazhdueshme	Shtator - Tetor 2026	4,280 €		Draft Programi për Trajnime të Vazhdueshme.
	Totali			127,737.00 €		
	3.1 Zhvillimi dhe zbatimi i procesit për vlerësim të nevojave	Departamenti i Programit të	Janar -			Raporti i vlerësimit të nevojave trajnuese për vitin 2027. Raporti vlerësimit të nevojave për hulumtime dhe botime për

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objektivi i përgjithshëm	Nën-objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
3.Zhvillimi i Programeve trajnuese, ngritja e cilësisë së trajnimeve, hulumtimeve dhe veprimtarisë botuese	trajnuese dhe nevojave për botime ligjore për përfituesit e AD-së	trajnimeve/Divizioni për analiza, hulumtime, botime dhe trajnues	Tetor 2026	440 €		vitin 2027.
	3.2 Zhvillimi i procesit për vlerësimin e ndikimit të trajnimeve dhe vlerësimin të performancës së trajnuesve për vitin 2026	Departamenti i Programit të trajnimeve Divizioni për analiza, hulumtime, botime dhe trajnues në koordinim me Divizionet e trajnimeve	Janar - Dhjetor 2026			Raportet me vlerësimin e ndikimit të trajnimeve i hartuar. Raporti i performancës së trajnuesve për vitin 2026 i hartuar.
	3.3 Zhvillimi i botimeve të reja dhe ofrimi i burimeve ligjore për përfituesit e trajnimeve pranë AD-së;	Departamenti i Programit të trajnimeve Divizioni për analiza, hulumtime, botime dhe trajnues	Janar-Dhjetor 2026	31,030		• Përmbledhje nga praktika e Gjykatës Supreme në çështjet penale dhe civile e hartuar dhe publikuar • Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Supreme të Kosovës e publikuar • Komentari i Drejtësisë për të mitur me raste nga praktika gjyqësore e hartuar dhe publikuar • Veprat penale kundër integritetit seksual, dhunimet ndaj fëmijëve e hartuar dhe publikuar • Përgjegjësia penale e personave juridikë e hartuar dhe publikuar • Praktikat për masat e diversitetit e hartuar dhe publikuar • Ndërmjetësimi në çështje familjare dhe vendimi i gjykatës në raport me marrëveshjen e ndërmjetësimit • Përmbledhje e vendimeve gjyqësore në fushën e lirisë së shprehjes nga gjykatat vendore e hartuar dhe publikuar • Udhëzues për arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë e

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objektivi i përgjithshëm	Nën-objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
						hartuar dhe publikuar • Udhëzues për paraburgimin e hartuar dhe publikuar
	3.4 Zbatimi i masave dhe politikave euro integruese si dhe raportimi i rregullt në mekanizmat përkatës.	Departamenti i Programit të trajnimeve Divizioni për analiza, hulumtime, botime dhe trajnues	Qershor -Dhjetor 2026			Raportet periodike të hartuara për Strategjinë për Sundimin e ligjit; Strategjinë për mbrojtjen nga dhuna në familje; Programi kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut; PKIE & Agjendën Evropiane; Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën dhe mekanizmat tjerë integruar; Raporti i përmbushjes së masave nga Strategjia e AD.
	3.5 Zhvillimi i procesit të rekrutimit të trajnerëve të përkohshëm;	Departamenti i Programit të trajnimeve Divizioni për analiza, hulumtime, botime dhe trajnues				Lista e trajnuesve të përkohshëm a miratuar
	3.6 Zhvillimi i strategjisë institucionale dhe planit të veprimit të Akademisë së Drejtësisë	Të gjitha njësitë sipas strukturës së AD-së	Janar-dhjetor 2026	30.000 €		Plani Strategjik dhe plani i veprimit i AD-së i miratuar.
	Totali			61,030 €		

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objekti i përgjithshëm	Nën-objekti	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
4. Avancimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë në fushën e trajnimeve dhe zhvillimit profesional	1 Bashkëpunimin dhe koordinimin me KGJK, KPK si dhe me Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës;	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme	Janar – Dhjetor			-Organizimi i takimeve për realizimin e trajnimeve të veçanta, të fushave me prioritet dhe trajnimeve mbi ndryshimet ligjore. -Organizimi i takimeve për avancimin e platformave digjitale në fushën e trajnimeve. -Mbështetja e koordinimit të projekteve të përbashkëta
	2 Bashkëpunimi me institucionet të sistemit të drejtësisë dhe avancimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me partnerët ndërkombëtarë	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme	Janar – Dhjetor	5.500 €		-Zhvillimi dhe realizimi i takimeve dhe tryezave me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë. -Raporti përmbledhës me rekomandime dhe konkluzioneve për avancimin e bashkëpunimit. -Marrëveshjet e bashkëpunimit
5. Ngritja e kapaciteteve profesionale administrative, cilësisë së shërbimeve administrative dhe shpenzimeve financiare të buxhetit						
5.1 Ngritja e cilësisë së shërbimeve ligjore dhe mbështetja e organeve të Akademisë së Drejtësisë	1 Hartimi dhe shqyrtimi i akteve nënligjore të Akademisë.	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme	Janar – Qershor	14.400€		- Miratimi i Rregulloreve për nëpunësit civil me status të veçantë të AD-së; - Miratimi i Rregullores për trajnues dhe mentor në Akademinë e Drejtësisë; - Miratimi i Rregullores për tarifat e trajnimeve për avokatët shtetërorë, avokatët dhe profesionet e lira në Akademinë e Drejtësisë; - Realizimi i punësive për hartimin e akteve nënligjore
	3. Monitorimi dhe interpretimi i ndryshimeve ligjore	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme	Janar – Dhjetor	3.800 €		- Informimi i njësive përkatëse mbi ndikimin e tyre dhe përkthimi i nevojshëm.
	Totali			18,200 €		
	1. Forcimi i komunikimit institucional përmes bashkëpunimit me institucionet relevante, organizatat partnere dhe grupet e interesit	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme Janar – Dhjetor				- Realizimi i takimeve dhe komunikimeve me institucione dhe partnerë relevantë. - Zhvillimi i mekanizmave të koordinimit dhe shkëmbimit të informacionit. - Rritja e ndërveprimit me palët e interesuara për çështje institucionale dhe trajnuese.
	2. Administrimi dhe përditësimi i rregullt i webfaqes zyrtare dhe		Janar –			- Publikimi i rregullt i njoftimeve në webfaqe, dhe platforma sociale (300 njoftime)

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objekti i përgjithshëm	Nën-objekti	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
5.2 Ngritja e Komunikimit Institucional dhe Marrëdhënieve me Publikun	kanaleve të komunikimit elektronik, përfshirë rrjetet sociale.	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme	Dhjetor			
	3. Organizimi i fushatave informuese, njoftimeve publike dhe aktiviteteve	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme	Janar – Dhjetor	2400 €		- Organizimi dhe realizimi i puntoris për rritjen e ndërgjegjësimit dhe promovimit për javën e aktivizimit kundër dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave gjatë vitit 2026. - Organizimi dhe realizimi i dy (2) takimeve informuese me studentët e Fakultetit Juridik;
	4. Hartimi dhe publikimi periodik i buletineve informuese për aktivitetet trajnuese dhe institucionale të Akademisë.	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme/Departamenti Programeve te Trajnimit	Janar – Dhjetor			- Hartimi dhe publikimi i buletinit mujore
	Totali			2400 €		
5.3 Avancimi i sistemeve të TI-së, mirëmbajtja dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve	1. Mirëmbajtja dhe administrimi i infrastrukturës së TI-së.	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme	Janar – Dhjetor	2,500 €		- Implementimi dhe mirëmbajtja e backup-it të rregullt të të dhënave si dhe mirëmbajtja e pajisjeve të TI-së. - Zbatimi i përditësimeve të rregullta të sistemeve - Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemit për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese
	2. Avancimi i përdorimit efektiv	Departamenti për	Janar –			- Sigurimi i mbështetjes teknike për staf gjatë përdorimit të

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objektivi i përgjithshëm	Nën-objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
	dhe të sigurt të platformave digjitale.	shërbime ligjore dhe te Përgjithshme	Dhjetor			sistemeve dhe pasjeve te TI-së.
	3.Avancimi i përdorimit te platformës se mësimit ne distance	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme	Janar – Dhjetor			- Vendorsja e moduleve te trajnimit nga platforma HELP (13 module). - Zhvillimi i 3 moduleve te trajnimit sipas Programit Vjetor te Trajnimit te Vazhdueshëm
	4. Avancimi dhe mirëmbajtja e sistemit për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme		15,000 €		- Raporti i administrimi dhe zhvillimi i sistemit te menaxhimit te aktiviteteve trajnuese, -Zhvillimi i shkëmbimit te informacionit ndërmjet sistemit te brendshëm dhe sistemeve KGJ dhe KPK.
	Totali			17,500 €		
5.4 Avancimi i kapaciteteve profesionale administrative, proceseve te personelit, dhe rritja e efikasitetit në proceset e punës;	1.Konsolidimit të strukturës organizative, zhvillimin e procedurave të rekrutimit	Departamenti BNJ	Janar dhjetor			- Plani i personelit i hartuar dhe i zbatuar -Menaxhimi dhe rregullimi i dosjeve të personelit në përputhje me legjislacionin në fuqi. -Mirëmbajtja dhe administrimi i sistemit për evidencën e hyrje-daljeve të stafit.
	2.Forcimi i kapaciteteve profesionale të stafit, përmes trajnimeve të vazhdueshme të brendshme dhe të jashtme.	Departamenti BNJ	Janar dhjetor			-Plani i trajnimeve i hartuar dhe i zbatuar sipas fushave të identifikuara në plan.
5.5 Ngritja e cilësisë së	1. Funkcionalizmi i ndërtesës se re te AD	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme		928,814 €		- Hartimi i planit te funksionalizimit i ndërtesës së re të AD-së, duke përfshirë pajisjet e inventarit, pajisjet e teknologjisë informative dhe pajisjet e tjera mbështetëse (sistem konferencial, smart board, monitorë për sallat e TI).

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objektivi i përgjithshëm	Nën-objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
shërbimeve të mbështetjes administrative, logjistike, dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike;	2. Zhvendosja ne ndërtesën e re te AD (zhvendosja i personelit, mallrave, shërbimeve, inventarit, pajisjeve dhe dokumentacionit arkivor).	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme	Janar Dhjetor	15, 000 €		- Hartimi i planit të mobilizimit për zhvendosjen në objektin e ri; - Plani i mobilizimit për zhvendosjen në objektin e ri.
	3. Inaugurimit të ndërtesës së re të Akademisë së Drejtësisë	Departamenti i Programit te Trajnimeve, Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme,	–	46,000 €		- Organizimi i ceremonisë se inaugurimit te ndërtesës se re te AD. .
	4. Zbatimi i procedurave të arkivimit dhe administrimit të dokumentacionit institucional,	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme	Janar – Dhjetor			- Plani i arkivimit; - Arkivimi i dokumenteve sipas Shenjave Unike të Klasifikimit dhe përcaktimi i afateve.
	5.Menaxhimi i pasurisë jo financiare	Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme				Raporti i inventarizimit te pasurisë jo financiare Raporti vlerësimit te pasurisë jo financiare
			totali	989,814 €		
5.6 Ngritja e cilësisë se furnizimeve me mallra dhe shërbime dhe menaxhimi efektiv i	1.Plani i prokurimit bazuar ne vlerësimin e nevojave për mallra dhe shërbime për vitin 2026	Zyrtari i Prokurimit dhe/ Departamenti i Programit te Trajnimeve, Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme,	Janar – Tetor			Raporti i vlerësimit te nevojave për mallra dhe shërbime Plani vjetore i prokurimit hartuar dhe raporti i zbatimit

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objektivi i përgjithshëm	Nën-objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
kontratave	2. Menaxhimi i kontratave, dhe vlerësimi i cilësisë së mallrave dhe shërbimeve	Zyrtari i Prokurimit dhe /Departamenti i Programit të Trajnimeve, Departamenti për shërbime ligjore dhe të Përgjithshme, dhe Zyrtari i Prokurimit	Janar – Dhjetor			Raporti i vlerësimit të menaxhimit të kontratave Raporti i vlerësimit të cilësisë së shërbimeve dhe mallrave
	3. Rritja e cilësisë së mallrave dhe shërbimeve , dhe zhvillimi i specifikimeve teknike	Zyrtari i Prokurimit dhe Departamentet, Divizionet dhe	Janar – Dhjetor			Hartimi i specifikimeve teknike për mallra dhe shërbime sipas planit të prokurimit për vitin 2026
5.7 Menaxhimi dhe zbatimi në mënyrë efektive të resurseve financiare	1. Plani i ekzekutimit buxhetit dhe shpërndarja e buxhetit sipas nevojave të AD	Departamenti i Programit të Trajnimeve, Departamenti për shërbime ligjore dhe të Përgjithshme, dhe Divizioni për buxhet dhe financa	Janar – Dhjetor			-Vlerësimi i nevojave për buxhet -Kërkesa buxhetore në bazë të numrit të Raporti financiar Mekanizmi i kontrollit të shpenzimeve
	2. Vlerësimi i nevojave për buxhet të AD	Departamenti i Programit të Trajnimeve, Departamenti për shërbime ligjore dhe të Përgjithshme, dhe Divizioni për buxhet dhe financa				Kërkesa Buxhetore e miratuar.
	3. Raportimi i shpenzimeve financiare dhe ekzekutimi i buxhetit	Departamenti i Programit të Trajnimeve, Departamenti për shërbime ligjore dhe				Raporti vjetor financiar.

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objektivi i përgjithshëm	Nën-objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
		te Përgjithshme, dhe Divizioni për buxhet dhe financa				
	4.Sistemi i kontrollit të shpenzimeve të departamenteve , divizioneve dhe njësive tjera të AD	Departamenti i Programit të Trajnimeve, Departamenti për shërbime ligjore dhe te Përgjithshme, dhe Divizioni për buxhet dhe financa	Janar dhjetor			Zhvillimi i sistemit të kontrollit të shpenzimeve dhe raportimi i shpenzimeve.
Mbikëqyrja e zbatimit të mandatit ligjor të Akademisë së Drejtësisë.	1. Raporti vjetor i punës dhe i Performancës për vitin 2025 dhe raportin financiar për 2025	Këshilli Drejtues	Dhjetor	4104 €		Raporti Vjetor i punës dhe performancës
	2. Miratojë listën e trajnuesve të përkohshëm, si dhe angazhimin e tyre në zbatim të programeve trajnuese	Këshilli Drejtues	Dhjetor PTV Sipas Nevojës PTF	4092 €		Lista e trajnuesve të miratuar.
	3.Listën e mentorëve për gjeneratat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar në trajnimin fillestar	Këshilli Drejtues	Janar - Dhjetor	4092 €		Lista e mentorëve për gjeneratat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të sapoemëruar, miratuar.
	4. Projekt buxhetin e AD-së	Këshilli Drejtues	Qershor	4292 €		Projekt buxheti i miratuar.
	5. Kërkesat e KGK-së dhe KPK-së për fillimin e trajnimit fillestar për gjyqtarët dhe prokurorët që janë në proces të rekrutimit	Këshilli Programor- Këshilli Drejtues	Janar- Dhjetor	1210 €		Kërkesat zyrtare të KGK-së dhe KPK-së për fillimin e trajnimit fillestar miratuar.

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objektivi i përgjithshëm	Nën-objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
	6. Programet fillestare për gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar	Këshilli Programor-Këshilli Drejtues	Janar-Dhjetor	4100 €		Programet fillestare për gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar janë hartuar dhe miratuar.
	7. Programin Vjetor për Trajnime të Vazhdueshme për vitin 2027	Këshilli Programor-Këshilli Drejtues	Nëntor	6865 €		Programi Vjetor për Trajnime të Vazhdueshme 2027 i miratuar.
	8. Plani për Hulumtime dhe Botime të AD-së	Këshilli Drejtues	Dhjetor	6592 €		Plani i miratuar në realizimin dhe publikimin e hulumtimeve dhe botimeve të AD-së.
	9. Planin e Punës dhe të Performancës për vitin 2027 si dhe çështje tjera që dalin sipas zhvillimeve gjatë vitit 2026	Këshilli Drejtues	Dhjetor	3892 €		Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2027 i miratuar.
	10. Raportit të Performancës së trajnerëve të angazhuar në programet trajnuese	Këshilli Programor-Këshilli Drejtues	Dhjetor	3892 €		Raporti vjetor i performancës së trajnerëve i i miratuar.
	11. Shqyrtimin dhe miratimin e rregulloreve për nëpunësit civil me status të veçantë të AD-së.	Këshilli Drejtues	Janar-Mars	32020 €		Rregulloret për nëpunësit civil me status të veçantë të AD-së janë shqyrtuar dhe te aprovuara.
	12. Shqyrtojë dhe miratoje strategjinë institucionale të AD-së	Këshilli Drejtues	Qershor-Nëntor	1750 €		Plani Strategjik i miratuar.
	Totali			87,501 €		
	1. Hartimin e programeve të trajnimeve të AD-së në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në	Këshilli Programor-Këshilli Drejtues	Korrik-Shtator	3082 €		Programi i trajnimeve i harmonizuar me nevojat e KGJK-së dhe KPK-së është finalizuar dhe miratuar.
	2. Rekomandojë listën e trajnerëve të përkohshëm të dalë nga	Këshilli Programor-Këshilli Drejtues	Shtator-Nëntor	3000 €		Rekomandimi i trajnerëve të përkohshëm është bërë në përputhje me rezultatet e konkursit dhe kriteret e parashikuara.

Plani i veprimit për zbatimin e Planit të Punës dhe Planit të Performancës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026

Objektivi i përgjithshëm	Nën-objektivi	Njësia përgjegjëse	Afati kohor	Buxheti	Burimi i financimit	Indikatori/Rezultati
Hartimi dhe zhvillimi cilësor i programeve trajnuese	konkursi i rekrutimit					
	3. Rishqyrtojë dhe vlerësojë raportin e performancës së trajnerëve të angazhuar nga AD-së në zbatim të programeve trajnuese gjatë vitit 2026	Këshilli Programor-Këshilli Drejtues	Dhjetor	2506 €		Performanca e shqyrtuar dhe Rekomandimet e miratuara.
	4. Raportin e Vlerësimit Vjetor të Nevojave Trajnuese	Këshilli Programor-Këshilli Drejtues	Tetor	2592 €		Raporti i Vlerësimit Vjetor është shqyrtuar dhe miratuar.
	5. Raportin e ndikimit të trajnimeve	Këshilli Programor-Këshilli Drejtues	Dhjetor	1300 €		Raporti i ndikimit është shqyrtuar dhe miratuar.
	Totali			9,780€		

Buxheti sipas kërkesës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2026 dhe sipas qarkores buxhetore 2026/1 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve:

Kategoria	2025	2026	Diferenca 2025- 2026	Kërkesa Buxhetore 2026	Diferenca Kërkesë - Buxhet 2026
Paga dhe Meditje	313,473	336,504	23,031	403,557	(67,053)
Mallra dhe shërbime	535,000	535,000	-	733,089	(198,089)
Shpenzime Komunale	16,500	16,500	-	32,700	(16,200)
Shpenzime Kapitale	-	-	-	958,814	(958,814)
Total Buxheti	864,973	888,004	23,031	2,128,160	(1,240,156)

7. Sfidat dhe rreziqet

Realizimi i Planit të Punës dhe të Performancës për vitin 2026 zhvillohet në një kontekst dinamik institucional dhe reformues, i shoqëruar me një sërë sfidash dhe rreziqesh që lidhen me kapacitetet financiare, infrastrukturore, njerëzore, ligjore, teknologjike dhe programore të Akademisë së Drejtësisë. Më poshtë paraqiten sfidat dhe rreziqet, të ndara sipas fushave dhe çështjeve që ndikojnë në zbatimin e Planit të Punës dhe të Performancës:

7.1 Sfidat dhe rreziqet në fushën e financave dhe përmirësimit të infrastrukturës

- Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara në kuadër të programeve trajnuese, veprimtarive hulumtuese dhe botimeve, si dhe kufizimet për zhvillim afatgjatë institucional;
- Mosndarja e buxhetit për funksionalizimin e ndërtesës së re të Akademisë së Drejtësisë, përfshirë pajisjen me inventar, mjete pune dhe infrastrukturë mbështetëse;
- Rritja e volumit të mallrave dhe shërbimeve për mirëmbajtjen e ndërtesës së re, me ndikim të drejtpërdrejtë në shpenzimet operative;
- Zhvendosja e aktiviteteve trajnuese, stafit, pajisjeve, inventarit dhe materialit arkivor në ndërtesën e re, e cila kërkon planifikim dhe koordinim të veçantë;
- Mungesa e mekanizmave për monitorimin e shpenzimeve sipas departamenteve dhe divizioneve.

7.2 Sfidat dhe rreziqet në fushën e burimeve njerëzore dhe administrimit

- Stafi i pamjaftueshëm për zbatimin e aktiviteteve trajnuese, hulumtuese dhe botuese, veçanërisht në kontekstin e rritjes së volumit të punës;
- Lëvizja e stafit në sektorë të ndjeshëm, si Divizioni i TI-së, për shkak të kufizimeve në kompensim dhe kushte pune;
- Vështirësitë në krijimin e komisioneve të pranimit për procedurat e rekrutimit, për shkak të numrit të kufizuar të stafit drejtues dhe profesional;

- Proceset e rekrutimit për pozitat e lira sipas legjislacionit të ri në fuqi, të cilat mund të ndikojnë në afatet e planifikuara të aktiviteteve.

7.3 Sfida dhe rreziqe ne çështjet e zbatimit te legjislacionit dhe avancimin institucional

- Nevoja për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Akademinë e Drejtësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira;
- Ndryshimet e shpeshta në legjislacion, të cilat kërkojnë harmonizim të vazhdueshëm të procedurave të brendshme dhe proceseve operative;
- Vonesat e mundshme në bashkëpunimin ndërinstitucional, me ndikim në realizimin në kohë të aktiviteteve trajnuese dhe hulumtuese.

7.4 Sfidat dhe rreziqet ne fushën teknologjike dhe të sistemeve të informacionit

- Funksionalizimi jo i plotë i sistemeve për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese (SMAT dhe databazës përkatëse);
- Pajisjet e vjetruara të teknologjisë informative dhe nevoja për kompjuterë dhe laptopë të rinj;
- Mosfunksionimi i pajisjeve për evidencën e hyrje-daljeve të stafit, që ndikon në saktësinë e të dhënave administrative.

7.5 Sfidat dhe rreziqet ne aktivitet trajnuese, hulumtuese dhe botuese

- Stafi i pamjaftueshëm dhe kapacitetet e kufizuara për zbatimin efektiv të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV);
- Zbatimi jo i plotë i kërkesave të përcaktuara në doracakun për trajnues, përfshirë instrumentet e vlerësimit para dhe pas trajnimit;
- Plotësimi i pamjaftueshëm i pyetësorëve të vlerësimit nga pjesëmarrësit, që kufizon matjen e ndikimit të trajnimeve;
- Zbatimi i trajnimeve për menaxhmentin e gjykatave dhe prokurorive në mungesë të ekspertizës së mjaftueshme;
- Anulimi ose vonesat në procesin e rekrutimit të prokurorëve të rinj, me ndikim të drejtpërdrejtë në planifikimin dhe realizimin e PTF-së;
- Nevoja për koordinim të veçantë me KGJK-në dhe institucionet përkatëse për trajnime të grupeve specifike;
- Mosrealizimi i punimeve për zhvillimin e botimeve ligjore sipas afateve të planifikuara;
- Inpute të pamjaftueshme nga përfituesit e Akademisë për mekanizmat e vlerësimit të nevojave trajnuese dhe botimeve të reja;
- Vështirësi në matjen e ndikimit të trajnimeve dhe botimeve, për shkak se përgjigjja ndaj instrumenteve të vlerësimit nuk është obligative;
- Përfshirja e pamjaftueshme e kuadrit ligjor në zhvillimin e botimeve, për shkak të kushteve dhe nivelit të ultë të kompensimit;
- Funksionalizimi jo i plotë i databazës për menaxhimin e aktiviteteve trajnuese dhe botuese.

8. Përfundimi

Plani i Punës dhe i Performancës për vitin 2026 është përgatitur duke u bazuar në mundësitë reale të Akademisë së Drejtësisë për përmbushjen e objektivave të saj të përgjithshme. Zbatimi i këtij plani realizohet kryesisht nga stafi i AD-së, përkatësisht nga struktura e re organizative, në përputhje me Rregulloren e re për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Akademisë së Drejtësisë.

Objektivat e përgjithshme janë identifikuar dhe përmbledhur duke marrë parasysh zhvillimet e reja, kërkesat e KGJK-së, KPK-së, gjykatave, prokurorive, si dhe nevojat e gjyqtarëve, prokurorëve dhe stafit mbështetës. Gjithashtu, janë konsideruar prioritetet dhe nevojat që rrjedhin nga dokumentet strategjike dhe procesi euro-integrues, me synimin e ngritjes dhe avancimit të profesionalizmit në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Plani përmban në detaje aktivitetet trajnuese dhe të tjera të përcaktuara me ligj, duke përfshirë njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre. Stafi i Akademisë do të angazhohet në përmbushjen e këtij plani, duke respektuar veprimet dhe afatet e përcaktuara për secilin aktivitet të parashikuar.

Përmes zbatimit të këtij plani, AD synon të kontribuojë në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së sistemit të drejtësisë në vend. Suksesi i aktiviteteve të planifikuara varet nga koordinimi ndërinstitutional dhe përkushtimi i vazhdueshëm profesional i stafit.

Në këtë mënyrë, Plani i Punës dhe Performancës shërben si udhërrëfyes strategjik për forcimin e rolit dhe kontributit të Akademisë në zhvillimin e mëtejshëm të sistemit gjyqësor dhe prokurorial.